

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5969
E martë, 7 janar 2020
çmimi 0.40 €

Gërzhaliu: Të ndalen agjenturat e lobeve për Termocentralin 'Kosova e Re'



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA PRITUR TË HËNËN NË NJË TAKIM KRYETARIN E LËVIZJES VETËVENDOSJE, PARTISË FITUESE TË ZGJEDHJEVE TË 6 TETORIT, ALBIN KURTI

AKTUALE



PAPUNËSIA RRIIT INTERESIMIN E MJEKËVE PËR TA LËSHUAR KOSOVËN F. 6

THAÇI DHE HARADINAJ PRANOJNË LETËR URIMI PËR FESTAT E FUNDVITIT NGA TRUMPI F. 5

PELEGRINËT SERBË NUK VIZITOJNË GJAKOVËN F. 7

NË LIQENIN E BATLLAVËS E TË BADOÇIT NIVELI I UJIT KA RËNË PËR 10 METRA F. 3

1/3 E STUDENTËVE NGA BURSA YCS PRESIN TA OFROJNË KONTRIBUTIN NË INSTITUCIONET E KOSOVËS F. 7

EKONOMI

EDHE POSTA E KOSOVËS UA UL PAGAT PUNONJËSVE F. 9

KULTURË

RIJKA DHE GALWAY, KRYEQYTETET E KULTURËS PËR VITIN 2020 F. 14



THAÇI I JEP VETËVENDOSJES 48 ORË AFAT SHITESË PËR TA PROPOZUAR KANDIDATIN PËR KRYEMINISTËR

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, nuk e ka mandatuar për kryeministër kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, në takimin e parë konsultativ. Shefi i shtetit ka bërë me dije se partisë që i ka fituar zgjedhjet e 6 tetorit ia ka dhënë 48 orë afat shitesë për ta propozuar kandidatin për kryeministër para se t'i marrë veprimet e radhës kushtetuese dhe ligjore. Kurse i pari i LV-së, Albin Kurti, ka bërë me dije se kjo parti, pas mbledhjes së Kryesisë, me anë të një shkrese për media do ta bëjë propozimin për kryeministër. Ndërsa LDK-ja është shprehur e gatshme t'i vazhdojë negociatat me LV-në, duke vlerësuar se pushtetet e balancuara dhe përgjegjësitë e përbashkëta janë jetike për funksionimin e koalicionit të mundshëm



MPJ u sugjeron qytetarëve të Kosovës ta shmangin qarkullimin nëpër Serbi



Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës u ka sugjeruar qytetarëve të Kosovës që ta shmangin qarkullimin në Serbi, ndërsa u ka kërkuar atyre që nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë, që të

kenë kujdes dhe maturi. Sipas MPJ-së, Serbia është një territor i cili nuk ofron as siguri minimale për integritetin fizik dhe juridik të qytetarëve të Kosovës dhe për familjarët e tyre

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiqi: Edhe Kosova mund të miratojë ligj të ngjashëm me atë në Mal të Zi

BEOGRAD, 6 JANAR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se nuk e përjashton mundësinë që edhe autoritetet e Kosovës të miratojnë një ligj për liritë fetare, të ngjashëm me atë që ka miratuar Mali i Zi. "E shoh këtë përmes përgatitjeve, përmes librave të tyre shkollorë. Fushata po zhvillohet me vite. Flitet për trashëgiminë e Kosovës, e cila duhet të jetë ndryshe nga ajo serbe", u tha Vuçiqi gazetarëve në Beograd.

Ai shtoi se serbët do të luftojnë si gjithmonë kur t'iu thuhet se "nuk mund të ruajnë emrin dhe mbiemrin e tyre, fenë dhe kishën, monumentet kulturore dhe trashëgiminë e tyre kulturore".

Kuvendi i Malit të Zi ka miratuar Ligjin për Lirinë e Fesë më 27 dhjetor të vitit të kaluar. Që nga ajo kohë janë zhvilluar edhe protesta nga besimtarë të Kishës Ortodokse Serbe, e cila e cilëson ligjin si përpjekje për të kapur pronën e Kishës në

Mal të Zi.

Qeveria malazeze e mohon një gjë të tillë.

Kisha Ortodokse Serbe e kundërshton formulimin në ligj, i cili thotë se të gjitha objektet fetare, që kanë qenë pronë e shtetit të Malit të Zi para humbjes së pavarësisë më 1918 e që më vonë nuk kanë kaluar në pronësi të ndonjë bashkësie fetare në mënyrë legale, do të njihen si pronë e shtetit dhe do të regjistrohen si thesar kulturor.



Fitorja e Milanoviqit, goditje për konservatorët në pushtet

Fitorja e Zoran Milanoviqit për president është një goditje për konservatorët në pushtet, në një moment kur Kroacia ka marrë presidencën e radhës së Bashkimit Evropian, ndërsa këtë vit pritet të zhvillohen edhe zgjedhjet parlamentare

ZAGREB, 6 JANAR - Zgjedhjet presidenciale të së dielës në Kroaci i fitoi kandidati i majtë Zoran Milanoviq, i cili sfidoi presidenten aktuale konservatore Kolinda Grabar-Kitaroviq. Kjo është një fitore e rrallë e liberalëve gjatë votimeve të zhvilluara kohët e fundit në Evropë dhe vjen në një moment kur Kroacia ka kryesinë e radhës së Bashkimit Evropian.

Kroatët patën reagime të ndryshme mëngjesit e së hënës për presidentin e ri të sapozgjedhur.

Sfidanti i majtë Zoran Milanoviq fitoi zgjedhjet presidenciale të së dielës përballë një kandidateje konservatore.

Është kjo një fitore e rrallë nga një kandidat liberal gjatë votimeve të kohëve të fundit në Evropën Qendrore.

Me 99% të votave të numëruara, Milanoviq, ish-kryeministër i vendit, fitoi 53%. Ndërsa Kolinda Grabar-Kitaroviq, grua e parë që u bë kryetare e shtetit kroat pesë vjet më parë, mori 47% të votave, ka njoftuar voa.

Rezultati është një goditje për konservatorët në pushtet, në një moment kur Kroacia ka marrë presidencën e radhës së Bashkimit Evropian, ndërsa këtë vit pritet të zhvillohen edhe zgjedhjet parlamentare.

Një banore e Zagrebit mendon



se Milanoviq do t'i sjellë më shumë sukses Kroacisë në Evropë.

"Mendimi im është se ky ndryshim është shumë i mirë. Mendoj se kështu do të jemi më të suksesshëm në Evropë. Milanoviq ka vërtet eksperiencë, karizmë, qëndrime. Personalisht, jam shumë e kënaqur dhe i gëzuar. I uroj gjithë të mirat", thotë Vera Boriq Herceg, banore e

Zagrebit.

Ndërsa një tjetër banor mendon se aftësitë gjuhësore të presidentes në largim, e bëjnë atë më të zonjën në komunikim.

"Personalisht isha në favor të Kolinda Grabar-Kitaroviq, sepse mendoj se ajo është më e lidhur me botën, është më e spikatur, flet disa gjuhë. Isha për të. Milanoviq nuk më pëlqen. Është arrogant dhe jo i sjell-

shëm", thotë Tomo Matiq, banor i Zagrebit.

Një banor i moshuar mendon se ndoshta do të kishte qenë më mirë të kishin kandiduar emra krejtësisht të rinj.

"Duhet të kishim parë gjetiu për kandidatë. Kjo nuk është dhe aq mirë. Milanoviq ishte kryeministër për 4 vjet. Kolinda ishte presidente për 5 vjet. Ju lutem, nuk ka njeri tjetër? Ndonjë më të ri? Ndoshta atëherë do të kemi një jetë më të mirë. Nuk ka tokë të dytë në botë si Kroacia - është vendi më i mirë, me natyrën më të mirë, shumë të pasur, deti, pyjet malet dhe fabrikat tona. Arritëm t'i shkatërojmë të gjitha. Shkatërruam gjithçka", thotë i moshuari Toni, banor i Zagrebit.

Kitaroviq zhvilloi një fushatë që promovonte "Kroacinë e vërtetë", diçka që Milanoviq e përkufizoi si tepër të rrezikshme. Në përfundim të procesit, ajo i uroi fitoren Milanoviqit.

PS-ja mban zgjedhjet më 29 shkurt

TIRANË, 6 JANAR - 9 shkurti i këtij viti ngjason shumë me 30 qershorin. Në rastin e parë qytetarët ju drejtuan kutive të votimit, pa pasur mundësi të zgjedhin, ndërsa në rastin e dytë, socialistët do u drejtohen kutive për të mos zgjedhur fare. Të paktën kështu ndodh me dy postet kyçe në parti.

Pasi zhvilloi "zgjedhje" (përmes referendumit) që të mos ketë zgjedhje në PS në 2016, Edi Rama nuk do të votohet as në 2020. Kësaj radhe, këtë ia garanton statuti. Gjurmët e Edi Ramës po i ndjek me përpikëri edhe Taulant Balla, duke e përjashtuar veten nga përballja me votë për

postin e sekretarit të përgjithshëm të PS-së.

Por ky është vetëm një problem! Partia Socialiste shkon në zgjedhje në një vit të brishtë dhe si për ironi të fatit, ashtu si zgjedhjet, kjo ditë vjen vetëm një herë në katër vjet. Të shkosh në zgjedhje do të thotë te kesh mundësi për të zgjedhur, ndëshkuar apo aprovuar, por kjo nuk do të ndodh tek socialistët.

Sipas statutit të miratuar në 2016, të gjithë duhet të shkojnë në zgjedhje, përveç kryetarit të Partisë Socialiste, në këtë rast Edi Rama.

Sipas nenit 40, pika 5 e statutit, thuhet se kryetari në momentin



që është kryeministër, atëherë i rinovohet automatikisht mandati.

Por Statuti i PS-së nuk vlen për

Taulant Ballën, sekretarin e përgjithshëm të PS-së. Sekretari i përgjithshëm është përjashtuar nga procesi i zgjedhjeve, duke e

kthyer këtë proces në një farsë.

Sekretari i përgjithshëm ka rol kyç në parti, pasi zëvendëson kryetarin, mban punimet e Asamblesë dhe mbikëqyr Statutin. Por ndryshe nga 30 qershori ku opozita refuzoi pjesëmarrjen në zgjedhje, Gazeta SHQIP mëson se shumë kundërshtarë të Ramës në parti kanë shfaqur interes për të garuar për postin e sekretarit. Ndaj kjo është arsyeja, që Rama kërkon ta mbajë fort Taulant Ballën.

Por ky veprim dëmton PS-së, demokracinë e brendshme në parti dhe traditën pozitive të zgjedhjeve.

MPJ u sugjeron qytetarëve të Kosovës ta shmangin qarkullimin nëpër Serbi



heqë dorë nga "praktikat fashiste dhe ta pranojë faktin që është pjesë e kontinentit evropian, ku liria e lëvizjes është e drejtë universale e secilit dhe respektohet pavarësisht agjendave politike". Javën që shkoi në Serbi u arrestua Nezir Mehmetaj, një qytetar i Kosovës, teksa po kthehej për në Kosovë pas një vizite mjekësore. Ndaj tij gjykata në Serbi mori vendim për paraburgim prej 30 ditësh.

KONJUFCA I BËN THIRRJE SERBISË TA LIROJË NEZIR MEHMETAJN

Kryetari i ri i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se me shqetësim e ka marrë lajmin për arrestimin e qytetarit të Kosovës, Nezir Mehmetaj, i cili po kthehej nga Serbia ku kishte qenë në spital për nevojat shëndetësore të nënës së tij. "Kjo është padrejtësi. Serbia po arreston në mënyrë arbitrare, cilin t'i teket, nga qytetarët e Kosovës të cilët kalojnë nëpër atë vend nga halli, jo nga qejfi. Me këto gjeste Serbia po na tregon se nuk ka ndryshuar ende mentalitetin politik sa i përket Kosovës e shqiptarëve, të cilët i trajton dhunshëm e me arbitraritet, sikur të jenë njerëz të dorës së dytë. Sjellje të tilla që targetojnë një etni e një vend fqinj nuk premtojnë aspak mirë për të ardhmen. I bëjmë thirrje Serbisë ta lejojë z. Nezir Mehmetaj të kthehet pranë vatrës e familjes së tij dhe ta ndryshojë qasjen që ka ndaj Kosovës e qytetarëve të saj. Jemi në shek. XXI e këto sjellje duhet t'i ndalni. Edhe pse s'kanë kaluar ende as dy dekada prej masakrave gjenocidale që bëtë kundër nesh, prapë njëjtë vazhdoni", ka shkruar Konjufca në llogarinë e vet në "Facebook".

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës u ka sugjeruar qytetarëve të Kosovës që ta shmangin qarkullimin në Serbi, ndërsa u ka kërkuar atyre që nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë, që të shfaqin kujdes dhe maturi. Sipas MPJ-së, Serbia është një territor i cili nuk ofron as siguri minimale për integritetin fizik dhe juridik të qytetarëve kosovarë dhe për familjarët e tyre

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 JANAR - Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës u ka sugjeruar qytetarëve të Kosovës që ta shmangin qarkullimin nëpër Serbi e, nëse nuk mund ta bëjnë këtë, të shfaqin kujdes dhe maturi gjatë qarkullimit atje. MPJ-ja përmes një njoftimi për media ka vlerësuar se Serbia nuk është më territor që ofron as siguri minimale për integritetin fizik dhe juridik të qytetarëve. "Duke rikujtuar komunikatën e 31 majit 2019, njoftojmë qytetarët e Republikës së Kosovës, me vendbanim në Kosovë apo jashtë vendit, që të shfaqin kujdes dhe maturi në rast se nuk mund ta shmangin qarkullimin nëpër territorin e Serbisë. Në përputhje me obligimin institucional dhe

ligjor për ta informuar publikun dhe për t'u kujdesur për sigurinë dhe integritetin e secilit qytetar të Kosovës, Ministria e Punëve të Jashtme vlerëson se Serbia nuk është më një territor i cili ofron as siguri minimale për integritetin e tyre fizik dhe juridik dhe as për familjarët e tyre. Për rrjedhojë, sugjerohet evitimi i përkohshëm i qarkullimit përmes këtij vendi", thuhet në njoftimin e MPJ-së. Në këtë njoftim theksohet se ky reagim vjen si rezultat i arrestimeve të vazhdueshme të qytetarëve të Kosovës në Serbi. Bazuar në arrestimet e qytetarëve, MPJ ka thënë se ka evidencë të mjaftueshme të konstatohet se Serbia po vepron në kundërshtim me praktikën e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe po shkel obligimet që dalin nga marrëveshjet e Brukselit.

"Qytetarë të dashur, dëshirojmë të kemi vëmendjen tuaj, pasi ky njoftim vjen si rezultat i arrestimeve të vazhdueshme të qytetarëve të Republikës së Kosovës nga ana e institucioneve të këtij vendi, gjithmonë në rrethana fiktive. Një numër i tyre madje edhe janë keqtrajtuar fizikisht dhe psikologjikisht. Bazuar në këto zhvillime, Ministria e Punëve të Jashtme ka bazë dhe evidencë të mjaftueshme të konstatoj se ndaj të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, Serbia, pa përjashtim, për qëllime politike dhe qëllime të tjera jodemokratike, në kundërshtim me praktikën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar dhe me të drejtën ndërkombëtare dhe atë evropiane, si dhe në kundërshtim me obligimet që dalin nga marrëveshjet e Brukselit,

jashtëligjshëm, mund t'ju ndaloj arbitrarisht kalimin në territorin e saj. Ministria e Punëve të Jashtme dhe të gjitha institucionet e vendit i kanë ftuar dhe vazhdojnë t'i ftojnë institucionet e Bashkimit Evropian, dhe jo vetëm, që të korrigjojnë këtë sjellje agresive të Serbisë, por që, fatkeqësisht, deri më tani kjo nuk ka pasur asnjë efekt. Ndryshe nga këto praktika primitive të Serbisë, Republika e Kosovës vepron në formë të matur, të civilizuar dhe demokratike dhe, për dallim, nuk i trajton qytetarët e Serbisë në forma jologjore dhe jodemokratike për aq kohë sa ata nuk janë të lidhur me krimin dhe i respektojnë ligjet e Republikës së Kosovës", thuhet në njoftimin e kësaj ministrie. Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës ka ftuar Serbinë që të

Në liqenin e Batllavës e të Badocit niveli i ujit ka rënë për 10 metra

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - Kompania Rajonale Ujësjellësi "Prishtina" ka njoftuar lidhur me gjendjen e liqeneve akumuluese sipërfaqësore, prej nga furnizohen qytetarët e Prishtinës dhe disa komuna të tjera me ujë të pijshëm. Sipas njoftimit, niveli i ujit në liqenin e Badocit është 640.08 metra mbi nivelin e detit ose 9.77 metra nën kapëderdhje, ndërsa liqeni i Batllavës 624.95 metra mbi nivelin e detit ose minus 10.05 metra. "Furnizimi me ujë të pijshëm dhe cilësor është 24 h pa ndërprerë. Ekipet e mirëmbajtjes

së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit janë në terren nga ora 08.30 deri në orën 22.00 për t'i sanuar defektet e shkaktuara nga rrjedhjet e ujit dhe zhblokimet e pusetave të ujërave të zeza. Me të filluar vitin 2020 do të ketë përmirësime të vazhdueshme të shërbimeve të ujit e kanalizimit e të tjera që ju ofrohen juve. Ne i monitorojmë vazhdimisht komentet tuaja dhe këtë vit, më shumë se asnjëherë, do t'ju ofrojmë cilësi në shërbim", është thënë në njoftimin e Kompanisë Rajonale Ujësjellësi "Prishtina".





Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të hënën në një takim kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, partisë fituese të zgjedhjeve të 6 tetorit, Albin Kurti

THAÇI I JEP VETËVENDOSJES 48 ORË AFAT SHITESË PËR TA PROPOZUAR KANDIDATIN PËR KRYEMINISTËR

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, nuk e ka mandatuar për kryeministër kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, në takimin e parë konsultativ. Shefi i shtetit ka bërë me dije se partisë që i ka fituar zgjedhjet e 6 tetorit ia ka dhënë 48 orë afat shtesë për ta propozuar kandidatin për kryeministër para se t'i marrë veprimet e radhës kushtetuese dhe ligjore. Kurse i pari i LV-së, Albin Kurti, ka bërë me dije se kjo parti, pas mbledhjes së Kryesisë, me anë të një shkresë për media do ta bëjë propozimin për kryeministër. Ndërsa LDK-ja është shprehur e gatshme t'i vazhdojë negociatat me LV-në, duke vlerësuar se pushtetet e balancuara dhe përgjegjësitë e përbashkëta janë jetike për funksionimin e koalicionit të mundshëm

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 JANAR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të hënën në një takim kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ku kanë diskutuar për mandatarin, përkatësisht kryeministrin e ardhshëm të Kosovës. Në këtë takim të shkurtër, të parin mes tyre, presidenti nuk e ka nominuar Kurtin për kryeministër, duke i dhënë 48 orë afat shtesë për ta bërë një gjë të tillë. Thaçi ka thënë se Kosova ka nevojë për formimin e shpejtë të qeverisë së re. "Tashmë është bërë hapi i parë i rëndësishëm i konstituimit të Kuvendit të

Republikës së Kosovës, për çka përsëri i përgëzoj deputetët e Kuvendit të Kosovës. Nevoja e formimit të Qeverisë është jetike për shtetin dhe qytetarët e Kosovës. Z. Kurti sot nuk ishte i gatshëm ta ofrojë propozimin e të nominuarit nga Lëvizja Vetëvendosje", ka bërë me dije Thaçi pas takimit me Kurtin. Më tej, ai ka theksuar se nëse LV-ja nuk propozon kandidatin për kryeministër do t'i marrë veprimet e radhës kushtetuese dhe ligjore. "Si president i vendit do ta ushtroj autoritetin tim kushtetues dhe ligjor të ruajtjes dhe kultivimit të unitetit politik e qytetar dhe orientimit euroatlantik të shtetit të Kosovës. Prandaj, kam vendosur që t'i

ofroj z. Kurti kohë shtesë edhe 48 orët e ardhshme për nominimin e kandidatit/kandidates për kryeministër të ardhshëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para se t'i marrë veprimet e radhës kushtetuese dhe ligjore", ka deklaruar Thaçi. Kurse lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, pas takimit me presidentin ka treguar se takimi nuk kishte efekte juridike. "Sot isha në takim me presidentin e Republikës, me ftesën e këtij të fundit. Ky ishte një takim i shkurtër konsultativ, pa efekte juridike. Në këtë takim disaminutësh unë e dëgjova presidentin i cili shprehu interesimin e tij për formimin sa më të shpejtë të

Qeverisë së Republikës së Kosovës, njëkohësisht tha që e di se na nevojitet një kohë e caktuar për këtë gjë. Por, gjithashtu, kërkoi që ne ta bëjmë propozimin", ka deklaruar Kurti.

Ai ka thënë se LV-ja shumë shpejt, me anë të një shkresë, do ta bëjë propozimin për kryeministër. "Mirëpo, në bazë të Kushtetutës së Kosovës dhe aktgjyqimit siç e kemi lexuar ne, është e nevojshme që ne këtë ta bëjmë me një shkresë me shkrim. Prandaj, për këtë kërkesë të presidentit në këtë takim konsultativ unë do të raportoj në Kryesinë e Lëvizjes Vetëvendosje dhe sa më parë që të mundemi do t'ia sjellim presidentit të Republikës propozimin tonë për kryeministrin e ardhshëm që ai duhet ta mandatojë sipas obligimit kushtetues që ka, në bazë të funksionit që ushtron", ka thënë Kurti.

Ky takim vjen pas tri ftesave që presidenti Thaçi i ka dërguar Kurtit. Dy ftesat e para, të cilat i ka dërguar presidenti Thaçi, më 27 dhjetor të vitit 2019, janë refuzuar nga Kurti, ndërkaq ndaj ftesës së tretë të presidentit, të dërguar më 30 dhjetor, për një takim të mundshëm më 31 dhjetor në orën 10:00, Kurti sërish e kishte refuzuar takimin e propozuar për datën 31 dhjetor dhe kishte propozuar datën 6 janar për zhvillimin e takimit, gjë që u realizua.

Rrjedhja e afatit prej 15 ditësh për formimin e Qeverisë së re të

Kosovës nis që nga momenti kur presidenti i vendit e mandaton të propozuarin e Lëvizjes Vetëvendosje për kryeministër të ardhshëm, gjë që gjatë takimit të së hënës nuk ndodhi. Formimi i qeverisë së re duhet ta ketë përkrahjen me vota të shumicës së thjeshtë të Kuvendit të Kosovës ose të 61 deputetëve.

Lideri i LV-së, Albin Kurti, ka bërë me dije se do të bëjë përpjeke për t'u takuar me zyrtarët e LDK-së për të arritur një marrëveshje për bashkëqeverisje. Megjithatë, Kurti para takimit me presidentin Thaçi, përmes një videomesazhi ka fajësuar LDK-në për mosarritjen e marrëveshjes. "Përkundër përpjekjeve të mia të vazhdueshme, nuk më është bërë e mundur një takim me kryetarin e LDK-së, para këtij takimi të sotëm me presidentin e shtetit. Askush prej nesh nuk e ka menduar që viti i ri 2020 do të na zë pa qeveri. Si kryeministër i ardhshëm i Republikës së Kosovës, si përfaqësuesi i juaji politik që ka marrë më së shumti vota në dy palë zgjedhjet e fundit parlamentare, theksoj se nuk kemi kohë për të humbur", ka thënë Kurti në këtë video-mesazh.

Madje përmes këtij videomesazhi, Kurti ka bërë publike edhe propozimet për ministra nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa ka kërkuar nga Isa Mustafa që edhe ai t'i propozojë pesë emra për ministra nga radhët e LDK-

Thaçi e merr në telefon presidentin e ri kroat, e uron për fitore

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka zhvilluar një bisedë telefonike me presidentin e porsazgjedhur të Republikës së Kroacisë, Zoran Milanović, të cilin e ka uruar për zgjedhjen në krye të shtetit mik të Kroacisë. "Në emër të qytetarëve të Republikës së Kosovës shprehja përkushtimin tonë për thellimin e partneritetit strategjik ndërmjet dy shteteve dhe popujve tanë. Presidentin e zgjedhur të Republikës së Kroacisë e përgëzoj edhe për marrjen e kryesimit të Këshillit të Bashkimit Evropian, ku Kosova pret një dinamikë të re në rrugëtimin e pandashëm drejt integritimeve euroatlantike", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".



së. "Nga Lëvizja Vetëvendosje! unë si kryeministër i qeverisë së re kam përzgjedhur: për zëvendëskryeministër të dytë të qeverisë, Haki Abazi, për ministere të Drejtësisë, Albulena Haxhiu, për ministër të Punëve

të Jashtme dhe Diasporë, prof. Blerim Reka, për ministër të Financave dhe Transfereve, prof. Besnik Bislimi, për ministër të Ekonomisë, Tregtisë dhe Industrisë, Rozeta Hajdari, dhe për ministër të Shëndetësisë dhe Sportit, Arben Vitia", ka thënë Kurti.

Ndërkohë Lidhja Demokratike e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e kryesisë të hënës, ku e ka ftuar Lëvizjen Vetëvendosje të reflektojë. "Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur sot, trajtoi situatën pas konstituimit të Kuvendit të Kosovës. LDK-ja vlerëson se është në interesin më të mirë të vendit implementimi i rezultatit të zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 dhe krijimi i institucioneve. LDK-ja konsideron se partisë që ka dalë e para i takon përgjegjësia për t'i themeluar institucionet", është thënë në komunikatën e LDK-

së. LDK-ja ka shprehur gatishmërinë që t'i vazhdojë bisedimet me Lëvizjen Vetëvendosje, mbi bazën e mirëbesimit dhe të partneritetit. "LDK-ja vlerëson se pushtetet e balancuara dhe përgjegjësitë e përbashkëta janë jetike për funksionimin e koalicionit të mundshëm, si dhe për funksionimin demokratik të institucioneve. LDK-ja fton Lëvizjen Vetëvendosje që të reflektojë mbi bazën e këtij parimi, në bazë të të cilit edhe është ndërtuar qëndrimi i LDK-së lidhur me ndarjen e pushteteve dhe balancën ndërmjet tyre", është theksuar në komunikatën e LDK-së.

Më 26 dhjetor të vitit që lamë pas është konstituuar përbërja e re e Kuvendit të Kosovës, ku kryetar i këtij institucioni është zgjedhur Glauk Konjufca nga Lëvizja Vetëvendosje.

Smaka: Presidenti veproi konform oportunitetit politik të kontekstit të rrethanave konkrete

Profesori i së Drejtës Kushtetuese, Riza Smaka, ka komentuar takimin në mes të presidentit Hashim Thaçi dhe liderit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti. Duke folur për deklaratën e Thaçit pas takimit me Kurtin, Smaka ka thënë se presidenti ka vepruar konform me oportunitetin politik të

kontekstit të rrethanave konkrete. "Në atë mënyrë ka krijuar një hapësirë kohore suficiente për ta aplikuar konkretisht dispozitën e nenit 95.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës", ka thënë profesori Smaka.

Çfarë thotë neni 95.1 i Kushtetutës së Republikës së

Kosovës: "Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë] 1. Pas zgjedhjeve, presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për ta formuar Qeverinë".

Thaçi dhe Haradinaj pranojnë letër urimi për festat e fundvitit nga Trumpi

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar një letër urimi për Vitin e Ri 2020 nga presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump. Në këtë letër, presidenti Trump uron presidentin Thaçi dhe popullin e Kosovës për festat e fundvitit.

Presidenti Thaçi e ka falënderuar presidentin Trump për urimin, duke ritheksuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë aleati më i rëndësishëm strategjik i Kosovës.

Në ditët e kaluara presidenti Thaçi ka pranuar shumë urime edhe nga liderë të ndryshëm

botërorë. Po ashtu, letër urimi për festat e fundvitit nga presidenti Trumpi ka pranuar edhe kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj. "Marrëdhënia e Kosovës me ShBA-në nuk është vetëm një raport bilateral ndërmjet dy vendeve, por është speciale dhe e përhershme", ka thënë Haradinaj.



Papunësia rrit interesimin e mjekëve për ta lëshuar Kosovën

PRISHTINË, 6 JANAR - Më shumë se 600 mjekë në Kosovë janë të papunë, prej të cilëve, sipas statistikave të Odës së Mjekëve të Kosovës, 60 janë mjekë specialistë. Institucionet publike shëndetësore, në anën tjetër, kanë kumtuar se kanë nevojë edhe për 5 000 mjekë të rinj që të punësohen. Ndërkohë në Odën e Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2019 thuhet se 115 mjekë kanë kërkuar dokumente për punësim jashtë Kosovës. Numri më i madh i tyre, bazuar në Odën e Mjekëve, kanë qenë mjekë të rinj, të cilët nuk kanë mundur të punësohen në Kosovë në profesionin e tyre, ndonëse sistemi shëndetësor ka mungesë të vazhdueshme të mjekëve.

Aktualisht Kosova nuk ka numër të saktë të mjekëve të cilët e kanë lëshuar vendin për të punuar në shtetet e Bashkimit Evropian apo edhe më larg. Gjatë vitit 2018 kanë qenë 110 mjekë që kanë kërkuar në Odën e Mjekëve certifikata që u duhet për punësim jashtë vendit. Kështu thotë Pleurat Sejdiu, kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës, i cili i tha "Radios Evropa e Lirë" se ndonëse nuk dihet se sa mjekë kanë ikur jashtë vendit, tendenca e tyre për punësim në vendet e Bashkimit Evropian, posaçërisht në Gjermani, është në rritje. "Për vitin 2019 kemi pasur 115 kërkesa për certifikata për punësim jashtë vendit, por nëse e shohim se sa mjekë po ndjekin kurset e gjuhëve të huaja, numri është ekstrem i madh dhe në bazë të kësaj shohim që pritet janë se mund të ketë një ikje edhe më të madhe. Rreth 95 për qind e mjekëve që kanë kërkuar certifikata janë mjekë të përgjithshëm dhe mjekë të papunë. Pra, këta mjekë kanë qenë duke kërkuar punësimin (në Kosovë), i cili nuk ka ndodhur dhe kanë ikur jashtë vendit", ka thënë Sejdiu. Sipas Sejdiut, ndonëse sistemi publik shëndetësor ka nevojë për



mjekë, meqë ka mungesë të tyre në të gjitha fushat mjekësore, punësimi nuk ndodh për shumë arsye. "Mendoj se është mungesa e një qasje më strategjike dhe jo e buxhetit, pasi ai mund të ribuxhetohet në bazë të prioritetëve. Por, nuk ka një koordinim të mirë mes komunave dhe ministrive, andaj edhe mjekët mbesin pa punë në Kosovë", është shprehur Sejdiu.

Në anën tjetër, Blerim Sylja, kryetar i Federatës Sindikale të Shëndetësisë, tha se një mjek specialist shtetit të Kosovës i kushton më shumë se 100 mijë euro që të shkollohet, derisa shton se më pas nuk kanë një strategji të qartë se si do të punësohen ata.

Sylja thotë se vetëm shteti gjerman është duke i kërkuar deri në 100 mijë mjekë në vit, andaj ky shtet, sipas tij, ka edhe programe të veçanta për t'i rekrutuar mjekët. "Kemi shpresuar që kalon Ligji i pagave, ku është trajtuar edhe çështja e mjekëve të rinj, të porsadiplomuara. Fatkeqësisht, ky ligj ka përfunduar në Gjykatën Kushtetuese. Ndërkohë kemi mungesë mjekësh në shumë vende të Kosovës. Por, punësimi nuk po

ndodh, derisa interesimi i vendeve të ndryshme në botë është shumë i madh për rekrutim të mjekëve. Në hulumtimin e fundit që e kemi bërë si sindikatë ka rezultuar se rreth 500 mjekë e kanë lëshuar Kosovën për punë dhe kushte të punës më të mira. Por, numri i saktë se sa mjekë ikin nga Kosova nuk dihet, pasi jo të gjithë lajmërohen se po shkojnë, përpos ata që lajmërohen në Odën e Mjekëve. Ndërkaq, sa iu përket infermierëve janë dy deri në tre në ditë që e lëshojnë Kosovën", ka deklaruar Sylja.

Ndryshe, një mjek specialist paguhet 600 euro në muaj. Profesionistët shëndetësorë në Kosovë në vazhdimësi kanë kërkuar që t'u rriten pagat. Me Ligjin e ri të pagave ishte paraparë që mjeku specialist të paguhet rreth 1 200 euro në muaj. Pagat me rritje ishte paraparë t'i marrin në muajin dhjetor të vitit 2019. Megjithatë, jo vetëm profesionistët shëndetësorë, por rreth 82 mijë persona që paguhet nga buxheti i Kosovës do të vazhdojnë t'i marrin pagat e njëjta, pa rritje, deri në muajin mars të vitit të

ardhshëm, pasi Gjykata Kushtetuese, pas kërkesës së parashtruar nga Avokati i Popullit, e ka pezulluar zbatimin e ligjit.

Ndërkohë, Blerim Sylja shton se pasojat do të shihen pas rreth pesë vjetësh, pasi ikja e mjekëve, mospunësimi i mjekëve të rinj dhe mosha mesatare e mjekëve aktualë në Kosovë që tashmë ka arritur 53 vjeç, sipas tij, do ta sjellë Kosovën në një gjendje të palakueshme. "Plakja të mjekët është marramendëse. Rreth 53 vjeç është mosha mesatare, kurse rritje të vendeve të punës nuk po ka. Mendoj se pacientët do ta pësojnë dhe mungesa e mjekëve do të bëhet problem, ku pacientit do t'i duhet të udhëtojë me kilometra për ta takuar një mjek specialist në të ardhmen", ka thënë Sylja.

Një nga mjekët që tashmë ka vendosur ta lëshojë Kosovën është edhe Yll Mehmeti i cili ka folur për "Radion Evropa e Lirë". Ylli është mjek radiolog, i cili ka vendosur të punojë në Gjermani në profesionin e vet, siç thotë ai, me kushte dhe pagë më të mirë. "Për të krijuar kontakte me cilindo shtet, për t'u punësuar si mjek, është

shumë e lehtë, pasi atje kërkohen shumë mjekë. Vetëm gjuha është një faktor shumë i rëndësishëm, që duhet ta flasësh, të tjerat janë shumë jorelevante për të gjetur punë dhe të sistemoresh, sidomos në Gjermani, aty ku edhe unë kam vendosur të shkoj. Ka shumë faktorë që më kanë bërë të krijoj këtë bindje për ta lëshuar Kosovën. E para dhe më kryesorja është perspektiva që ofrojnë vendet e Perëndimit, në këtë rast Gjermania, e cila ofron të ardhura më të mira në krahasim me vendin tonë", ka deklaruar Mehmeti.

Në Ministrinë e Shëndetësisë, drejtori për Informim, Faik Hoti, thotë se punësimi është i lidhur me nevojat që i kanë institucionet shëndetësore dhe buxhetin në dispozicion për punësimin e mjekëve. "Një problem që e ka shoqëruar punësimin e mjekëve në kohë optimale pas licencimit të tyre është se ka institucione që janë të ngarkuara me profile të caktuara, ndërsa kanë mungesë të disa profileve specifike, sikur që interesimi i mjekëve është shumë më i madh për të punuar në zona urbane e shumë më pak në zona rurale. Po ashtu, është fakt i njohur se për vite të tëra nuk ka pasur një harmonizim midis kërkesave të institucioneve shëndetësore për mjekë dhe numrit të studentëve të regjistruar në mjekësi, që do të thotë se një resor, duke lejuar numër më të madh të studentëve në mjekësi, e ka futur në presion resorin tjetër për t'i punësuar ata pas diplomimit si mjekë", ka deklaruar Hoti.

Ai ka shtuar se megjithatë, duke e parë nevojën e ruajtjes së kuadrit mjekësor në vend dhe zhvillimit të sektorit shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë është duke finalizuar Planin strategjik të resurseve humane në shëndetësi dhe është e pritshme që një numër i konsideruar i mjekëve të papunë do të angazhohen në punë në vitin 2020.

I mbetën kikirikët në fyt, i shpëtohet jeta fëmijës në QKUK

PRISHTINË, 6 JANAR (ER) - Në Klinikën e Otorinolarinologjisë së Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) i është shpëtuar jeta një vajze katërbëdhjetëmuajshe. "Mjekët e ORL-së, në bashkëpunim me ata të Klinikës së Anesteziologjisë e Reanimacionit dhe Klinikës së Pediatrisë, arritën që pas intervenimeve ta shpëtojnë foshnjën katërbëdhjetëmuajshe. Ajo kishte përpirë kikirikë, copëza të të cilëve i kishin mbetur në fyt.

Duke parë gjendjen e fëmijës, prindërit fillimisht ishin drejtuar në Klinikën e Pediatrisë, ndërkohë fëmijës po i shtoheshin problemet me frymëmarrje. Me rekomandim të mjekut pediatër, fëmija drejtohet në Klinikën e ORL-së. Pas konsultimit ndërmjet mjekëve të tri klinikave, në mënyrë konsiliare vendoset që fëmijës t'i bëhet trakio bronkoskopi (ndërhyrje në rrugët e frymëmarrjes)", ka njoftuar QKUK-ja.

Sipas këtij njoftimi, kësaj vajze i

janë hequr katër copëza të kikirikut. "Pasi ishte ftuar edhe ekipi shtesë i ORL-së, për të asistuar në kryerjen e kësaj procedure, fëmijës i hiqen katër copëza kikiriku dhe i lirohen rrugët e frymëmarrjes. Për të gjitha këto procedura ishte marrë pëlqimi nga familjarët. Kjo procedurë është kryer me aparaturnë e re të bronkoskopisë, me të cilën është furnizuar së fundmi Klinika e ORL-së", është thënë në këtë njoftim.



1/3 e studentëve nga bursa YCS presin ta ofrojnë kontributin në institucionet e Kosovës

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINE, 6 JANAR - "Imagjinoni të kemi mundësi t'i dërgojmë të rinjtë më të talentuar të Kosovës në studime në universitete më prestigjioze evropiane pa asnjë kosto financiare. Më pastaj që këta të rinjtë e Kosovës të tregojnë suksese të jashtëzakonshme në studimet e tyre, duke fituar çmimet më të larta akademike, në mesin e studentëve nga e gjithë Evropa. Dhe në fund, institucionet e Kosovës të refuzojnë t'i pranojnë këta të rinjtë në institucione. Në fakt, nuk ka nevojë ta imagjinoni këtë, se kjo po ndodh", është bërë me dije në një komunikatë për media të Institutit EPIK.

Sipas këtij instituti, bursa e Bashkimit Evropian për studime

të nivelit master në universitetet evropiane, e njohur si Skema e Profesionistëve të Rinj (Young Cell Scheme YCS) është ndër projektet më të suksesshme të BE-së në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor. "Përderisa BE-ja mbulon të gjitha shpenzimet e bursistëve, është obligim i institucioneve të Kosovës ta sigurojnë punësimin e tyre në administratën publike. Në këtë formë, bursa kontribuon në ndërtimin e një administrate të pavarur, me integritet dhe profesionale. Gjatë vitit 2019 shoqëria civile, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, ka monitoruar zbatimin e bursës YCS dhe njëkohësisht jemi zotuar se do të vazhdojmë t'i përcjellim zhvillimet sa i përket bursës YCS dhe punësimin e bursistëve në institucionet shtetërore me

qëllim të krijimit të një administrate me integritet, të pavarur dhe profesionale dhe në shërbim të qytetarëve. Në këtë drejtim, shprehim shqetësim që nga 50 bursistë të cilët kanë përfunduar studimet e tyre master gjatë vitit 2019, 1/3 e tyre ende nuk janë punësuar brenda institucioneve të Kosovës", është theksuar në komunikatën e Institutit EPIK.

Studentët bursistë kanë vijuar studimet në universitetet prestigjioze në Holandë, Angli, Belgjikë, Francë, Austri, Gjermani dhe Irlandë. "Kanë vijuar studimet në fusha të veçanta dhe deficitare siç janë: ndërmarrësia sociale, menaxhimi mjedisor dhe energjetik, e drejta e punësimit, sistemet statistikore, qeverisja globale ekonomike dhe çështjet publike,



tregtia ndërkombëtare dhe e drejta e investimeve etj. Në këtë drejtim ftojme të gjitha institucionet shtetërore për punësimin sa më të shpejtë të bursistëve nga bursa YCS me qëllim të

evitimit të rrezikimit të bursës dhe mundësive për generatat e ardhshme dhe avancimin e institucioneve të Republikës së Kosovës", është thënë në komunikatën e këtij instituti.

Pelegrinët serbë nuk vizitojnë Gjakovën



GJAKOVË, 6 JANAR - Pelegrinët serbë nuk kanë shkuar në Gjakovë për ta vizituar Kishën Ortodokse ashtu sikurse në vitet e kaluara më 6 janar. Mosshkuarjen e tyre e ka konfirmuar komandanti i Policisë së Kosovës për rajonin e Gjakovës, Kristë Gjokaj. Përmes telefonit, Gjokaj ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se nuk kanë marrë asnjë njoftim zyrtar për ndonjë vizitë të pelegrinëve serbë. Ai ka bërë me dije se po ashtu dhjetëra qytetarë të Gjakovës që kishin dalë të protestojnë afër kishës janë shpërndarë të qetë. "Nuk ka pasur asnjë kërkesë nga pelegrinët serbë që sot ta vizitojnë Gjakovën. Përderisa nuk ka pasur ndonjë paralajmërim, nuk mund të presim që do të vijnë. Ndërkohë, një grup prej 30 qytetarëve kanë protestuar

afër Kishës Ortodokse", ka thënë Gjokaj.

Edhe përfaqësuesi i Shoqatës së Personave të Zhvendosur nga Gjakova, Gjokica Stanojeviq, ka thënë se qytetarët serbë të zhvendosur nga Gjakova kanë anuluar vizitën e tyre pasi, siç ka thënë ai, ishin informuar se do të kishte "tubime problematike" afër kishës. "Për arsye që ta përbushim këtë ditë të paqes, ne hoqëm dorë, edhe pse një numër i madh ishim të gatshëm të nisemi", ka thënë ai. Sipas tij, fajtorë pse qytetarët serbë të zhvendosur nga Gjakova nuk mund t'i vizitojnë faltoret e tyre janë udhëheqësit e dialogut Kosovë - Serbi.

Çdo vit, për festën e Krishtlindjes Ortodokse, qytetarë serbë vizitojnë Kishën Ortodokse në Gjakovë.

Pezullohen të gjitha vendimet për operimin e gurëthyesve në Malishevë

MALISHEVË, 6 JANAR (ER) - Kuvendi i Komunës së Malishevës të hënën ka mbajtur mbledhjen e XII të radhës, e cila ishte shtyrë dy herë gjatë muajit dhjetor. Kjo mbledhje është drejtuar nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, Rrahim Morina. Kuvendi i Komunës së Malishevës në këtë mbledhje ka marrë disa vendime, e në mesin e këtyre vendimeve është edhe ai për pezullimin e të gjitha vendimeve dhe pëlqimeve për operimin e kompanive të gurëthyesve në territorin e Komunës së Malishevës.

Po në këtë vendim Kuvendi i Komunës së Malishevës ka kërkuar nga organet përgjegjëse që të marrin masa për revitalizimin e hapësirave të degraduara nga gurëthyesit, si dhe në të ardhmen, pëlqimet dhe vendimet në kërkesat e operatorëve për këtë veprimtari t'i lëshojë Kuvendi i Komunës. Ky vendim i Kuvendit të Komunës është marrë pas shqyrtimit të peticioneve të fshatrave Bellanicë, Turjakë dhe Panorc lidhur me përgatitjet për operim të gurëthyesve në afërsi të fshatrave.



Flet për "Epokën e re", Safet Gërxhaliu

Të ndalen agjencitë e lobeve p

Njohësi i zhvillimeve ekonomike në vend, Safet Gërxhaliu, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është e rëndësishme që sa më parë të formohet qeveria. Ai ka thënë se promovimi i dialogut, analizimi i thuktë i taksës, ndërtimi i termocentralit "Kosova e Re", "Trepça", si dhe emërimi i atasheve ekonomikë duhet të jenë në fokusin e qeverisë së ardhshme. Sa i përket Termocentralit "Kosova e Re", ai ka thënë se duhet të ndalohen agjencitë e lobeve të caktuara



EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 6 JANAR - Njohësi i zhvillimeve ekonomike në vend, Safet Gërxhaliu, i cili është dhe sekretar i përgjithshëm në Forumin Investiv të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor në Trieste, ka thënë se është i nevojshëm krijimi i Qeverisë së Kosovës dhe kompletimi i kabinetit qeveritar që, sipas tij, duhet të jetë me individë të përgatitur profesionalisht, me

përvojë dhe me vlera të larta që do ta përmirësojnë imazhin e vendit në arenën ndërkombëtare.

Në këtë bisedë për gazetën "Epoka e re", Gërxhaliu ka thënë se qeverisja e ardhshme duhet ta ketë në fokus promovimin e dialogut qoftë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo me vendet e Bashkimit Evropian. "Është e rëndësishme që të arrihet marrëveshja në mes të dy parterëve dhe ta kemi kompletimin e kabinetit qeveritar. Çdo ditë e

Taksa dhe tregu me karakter etnik në Kosovë

PRISHTINË, 6 JANAR - Pas më shumë se një viti të zbatimit të taksës 100 për qind ndaj të gjitha importeve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, tregu i Kosovës në pjesën më të madhe është zbrazur nga produktet e importuara nga këto dy shtete. Ndërkohë që në dhjetë komunat e banuara me popullatë serbe, në dyqane hasen në sasi të bollshme këto produkte, sidomos nga Serbia. Sipas të dhënave zyrtare, thuhet se rreth 6 milionë euro janë mallra të importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.

Adriatik Stavileci, zëdhënës në Doganën e Kosovës, tha për "Radion Evropa e Lirë" se nga shuma e përgjithshme, 4 milionë euro janë mallra nga Serbia, kurse 2 milionë të tjera nga Bosnjë e Hercegovina. Para vendosjes së taksës, shuma apo vlera e mallrave të Serbisë të importuara në Kosovë arrinte në rreth 450 milionë euro, apo mbi 1.2 milion euro brenda ditës. Stavileci thotë



se nëse krahasohet me periudhën e para taksës, ka rënie deri në 99 për qind të produkteve nga këto dy shtete. Megjithatë, edhe pse rënia e importit nga Serbia, sipas shifrave zyrtare, është në 99 për qind, në komunat e banuara me shumicë serbe, në katër komunat veriore, por edhe në ato në pjesën qendrore të Kosovës, mund të hasen pa problem produkte nga Serbia. Kështu pohojnë edhe vetë qytetarët serbë që jetojnë në këto komuna.

Verica, një qytetare nga Mitrovica Veriore, thotë se mund të furnizohet me të gjithë artikujt, si edhe para taksës. "Janë të gjitha, janë të gjitha... vetëm paratë duhen", thotë ajo.

Edhe Milica, po ashtu nga Mitrovica Veriore, thotë se ka produkte, por ajo preferon që të furnizohet vetë në Serbi për shkak të çmimeve më të lira sesa në tregun e Kosovës.

Se prodhimet apo mallrat nga Serbia dhe Bosnja Hercegovina

janë të pranishme në dyqane nëpër komunat e banuara me shumicë serbe, nuk e ka mohuar as drejtori i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha. Ai në një intervistë "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se këto mallra janë në sasi të vogël dhe nuk ndikojnë në tregtinë ligjore të Kosovës.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për taksën ndaj importeve nga Serbia ka ndikuar edhe te qytetarët apo blerësit në Kosovë, sidomos te popullata shumicë. Ata thonë se nuk i preferojnë produktet nga Serbia, të cilat edhe ashtu në pjesën më të madhe të tregut në Kosovë, përjashtuar komunat e banuara me shumicë serbe, tashmë janë zhdukur nga vitrinat e shitjes.

Nezafete Jakupi nga Prishtina, e cila punon në sektorin e arsimit, pranon se para vendosjes së taksës është furnizuar me disa produkte nga Serbia, por pas zbatimit të kësaj takse ajo thotë se as nuk ka blerë më produkte nga Serbia dhe as nuk po hasë më në këto

mallra nëpër dyqane.

Një efekt tjetër i taksës është pikërisht ndikimi i saj në rritjen e çmimeve në tregun e Kosovës. Fidani Çerkini nga Prishtina thotë se nuk ka më mallra nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina nëpër dyqane, por çmimet në disa artikuj janë rritur.

Për mungesën e produkteve nga Serbia, por edhe ato nga Bosnjë e Hercegovina, tregtarët janë përkujdesur që t'i zëvendësojnë ato me mallra të importuara nga vende të tjera. Në bazë të statistikave të Doganës së Kosovës, Gjermania ka një rritje të eksporteve në Kosovë, pasuar nga Turqia, Kina, Shqipëria dhe Italia. Para vendosjes së taksës doganore, Serbia ishte eksportuesja më e madhe e produkteve në Kosovë. Ky shtet, para 21 nëntorit, të vitit 2018 kur u vendos taksa 100 për qind gjatë një dite ka eksportuar në Kosovë mallra në vlerë prej rreth 1.2 milion eurosh apo rreth 450 milionë euro brenda një viti.

Ër Termocentralin 'Kosova e Re'



humbur është në dëm për ardhmërinë e Kosovës. Suksesi më i madh është në qoftë se arrihet t'i ndalim problemet nga e kaluara. Qeverisja e ardhshme duhet ta ketë në fokus promovimin e raporteve qoftë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo me vendet e Bashkimit Evropian për ta vendosur veten në binarë të ardhmërisë, që duhet të jenë të fokusuar në zhvillim ekonomik dhe në përsheptim të proceseve integruese në partneritet strategjik", është shprehur ai.

Gërxhaliu ka thënë se duhet të analizohet me kujdes edhe taksa e vënë ndaj Serbisë dhe Bosnjë Hercegovinës. "Taksa duhet të analizohet mirë. Duhet të kemi vendime të analizuara. Dua të besoj se kabineti i ardhshëm qeverisës do të ketë ekspertë profesionalë, mirëpo nuk duhet të jetë temë vetëm taksa, pasi Kosova ka probleme edhe më të mëdha. Prandaj bëj thirrje për një dialog të mirëfilltë", ka thënë ai.

Po ashtu, Gërxhaliu, ka apeluar te shoqëria civile dhe lobet e ndryshme në Kosovë, të cilët janë kundër ndërtimit të Termocentralit "Kosova e Re", që t'i ndalojnë agjenturat e tyre dhe mos të veprojnë në dëm të Kosovës. Sipas tij, është më se e dëmshme që Kosova të varet

nga importi i energjisë kur kihat parasysh dhe importi i lartë në tërësi në nivel vendi. "Ju e dini se në Kosovë dhe rajon ka lobistë shumë të fuqishëm për energji elektrike. Këta lobistë, qoftë nga Kosova, Serbia, Bosnja apo Mali i Zi, kanë raporte të mira me qarqet politike në Kosovë. Shqipëria, Mali i Zi dhe Bosnja janë duke ndërtuar kapacitete të reja të energjisë elektrike. Besoj se Kosovës nuk i bëhet nder që të jetë importuese edhe e energjisë elektrike kur dihet se çfarë niveli të lartë të importit kemi. Prandaj, ajo çfarë duhet të kërkohej nga shoqëria civile është të bazohet në transparencë dhe analizë të mirëfilltë dhe të ketë garanci për teknologji të sofistikuar, për teknologji dhe mbrojtje të ambientit dhe ambientalizmit. Në këtë drejtim duhet të gjenden modalitete që projekti të vazhdohet. Në Kosovë kemi organizata të ndryshme joqeveritare që financohen nga qarqe të caktuara dhe më shumë të mëdha, për të vetmin qëllim që Kosova të jetë e varur nga importi", është shprehur ai.

Gërxhaliu ka thënë se në fokus të qeverisjes së ardhshme duhet të jetë dhe rimëkëmbja e "Trepçës". "Nuk mjafton vetëm

një ligj apo dokument për këtë ndërmarrje. Vetë fakti që 'Trepça' është barrë e qeverisë, është mjerim i madh. Duhet vërtet të punohet dhe të mendohet më e mira për të", u shpreh ai.

Sipas njohësit të zhvillimeve ekonomike në vend, Safet Gërxhaliu, në mënyrë që të bie niveli i importit, të rriten investimet e huaja dhe të përmirësohet imazhi i Kosovës në arenën ndërkombëtare, Kosova më në fund duhet të ketë dhe atashe ekonomikë. Ai ka shtuar se këta atashe ekonomikë nuk duhet të emërohen në baza partiake, por në bazë të vlerave. "Me të vërtetë është koha kur duhet të mendohet për zhvillimin ekonomik. Andaj, dua të besoj se qeverisja e ardhshme do të vetëdijësohet nga gabimet e së kaluarës, pas emërimeve të njerëzve nëpër ambasada dhe konsujve të pakualifikuar dhe pa përvojë profesionale. Prandaj, qeverisja e ardhshme duhet t'i ketë në fokus atashetë ekonomikë, duke i marrë për bazë vlerat të cilat ata i kanë. Nëse dëshirojmë të kemi investime të huaja direkte, qoftë nga Evropa apo vendet e tjera të botës, si dhe rritje të ekspertëve nga Kosova, atëherë duhet të kemi dhe atashe ekonomikë", ka deklaruar Gërxhaliu.

Edhe Posta e Kosovës ua ul pagat punonjësve

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Punonjësit e Postës së Kosovës nga muaji janar i këtij viti do t'i marrin pagat me grada të reja, konkretisht me ulje. "Për punonjësit me gradat: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12 grada e re është për 10 për qind më e vogël. Për punonjësit me gradat 13, 14, 15, 16 dhe 17 grada e re është për 15 për qind më e vogël. Pagat me gradat e reja do të aplikohen nga muaji janar 2020. Po ashtu, ju njoftojmë se pas nxjerrjes së akteve të nevojshme do të bëhet pagesa e përvojës së punës prej 0.5 përqindësh sa më shpejt që të jetë e mundshme. Kjo ndikon që ulja e pagave për shumicën e punëtorëve, sidomos e atyre me përvojë më të gjatë, të mos vërehet fare. Gjithashtu, edhe me hyrjen në fuqi të Ligjit të Pagave nuk do të ketë ulje tjetër

të pagave për gradat 1-12", është bërë me dije në njoftimin e brendshëm të këtij institucioni për punëtorët, të cilin njoftim e ka siguruar "Epoka e re".

Në këtë njoftim thuhet se Posta po përballet me gjendje të rëndë financiare, gjë që është marrë si shkas për ulje pagash. "Siç jeni të informuar, Posta e Kosovës po përballet me vështirësi financiare që një kohë të gjatë. Zhvillimi i tregut të teknologjisë informative ka dhënë efektet e veta edhe te shërbimi postar në vend, që ka rënë dukshëm përdorimi i shërbimit të letrës dhe shërbimit postar në përgjithësi. Rënia e shërbimit postar dhe mosofrimi i përkrahjes së institucioneve të Kosovës për subvencionim të shërbimit postar ka ndikuar në gjendjen financiare të Postës së Kosovës dhe punonjësve të saj. Kjo gjendje financiare, përveç vonesave në



ekzekutimin e pagave, po shkakton edhe probleme të tjera të natyrës teknike dhe operative dhe vonesa në obligimet që kemi për funksionim dhe mungesë të investimeve për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjes. Përkundër

zhvillimeve të projekteve të reja që janë implementuar nga Posta e Kosovës si: Rritja e numrit të pagesave të IFJB-së, kontratatave të reja me institucione mikrofinanciare dhe bankare dhe projekte të tjera, prapëseprapë është vlerësuar si

e vështirë që të mbulohet kostoja në raport me të hyrat. Andaj kemi qenë të detyruar të bëjmë shkurtime edhe në shpenzimet në kategorinë e pagave. Me këto shkurtime më së shumti është prekur niveli i lartë menaxherial, ndërsa për kategoritë e tjera kemi bërë uljen më të vogël të mundshme", është thënë në letrën dërguar punonjësve të Postës së Kosovës.

Po ashtu, edhe Bordi i Telekomit të Kosovës para tri ditësh ka marrë vendim për t'i zvogëluar pagat për të gjithë punëtorët e këtij institucioni. "Koeficienti i secilës gradë për të gjithë punëtorët pa dallim zbritet për 10 për qind përjashtuar pozitave e larta të parapara me Ligjin për Ndërmarrje Publike, ku zbritja e koeficientit aktual është për 20 për qind, duke filluar nga data 01. 01. 2020", është thënë në vendimin e Telekomit të Kosovës.

Ftohen prizrenasit të aplikojnë në projektin për ndërtimin e shtëpive

PRIZREN, 6 JANAR (ER) - Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka ftuar qytetarët e Komunës së Prizrenit që të aplikojnë në thirrjen e kësaj drejtorie për të përfituar nga

projekti për ndërtimin e shtëpive, meremetimin e shtëpive dhe banesave, si dhe për furnizim me material ndërtimor. Kjo komunë ka bërë me dije se nga ky projekt

do të mbështeten familjet skamnore pa strehim dhe ato me shtëpi të dëmtuara nga vjetërsia. "Pyetësi i plotësuar dhe dokumentet (dëshmitë) për vërtetimin e gjendjes

së banimit duhet të dorëzohen në sportelet e administratës komunale, nga sot 06.01.2020 deri më 29.02.2020", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



Lladrovci emëron katër drejtorë të rinj

DRENAS, 6 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka bërë me dije se ka emëruar katër drejtorë të rinj në krye të drejtorive të kësaj komune. Drejtorët e emëruar nga Lladrovci janë: Muhamet Gjoka, drejtor i Drejtorisë Komunale për Arsim, Endrit Gllareva, drejtor i Drejtorisë për Infrastrukturë lokale, Ruzhdi Lestrani, drejtor i Drejtorisë për

Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Milaim Hajdari, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit. Me këtë rast, Lladrovci i ka uruar drejtorët e rinj, duke kërkuar nga ta realizimin e prioritetëve të këtyre drejtorive. "Të emëruarve u uroj punë të mbarë dhe pres realizimin e prioritetëve në dobi të qytetarëve. Sukses dhe punë të mbarë!", ka thënë Lladrovci.



Ilazi: Përkushtimi institucional për punë do të vazhdojë edhe në këtë vit



KAÇANIK, 6 JANAR (ER) - Puna dhe përkushtimi institucional për krijimin e kushteve sa më të mira për qytetarët e Komunës së Kaçanikut do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020. Kështu ka thënë të hënën në takim e parë për këtë vit të ekzekutivit të Komunës së Kaçanikut, i cili është udhëhequr nga kryetari i kësaj komune, Besim Ilazi dhe nënkryetari Ylber Bajra. "Në këtë takim u shpallën planet e punës për vitin që sapo kemi filluar. Sipas ekzekutivit komunal, edhe viti 2020 do të jetë i mbushur me aktivitete komu-

nale me dhjetëra projekte kapitale që për qëllim kryesor kanë mirëqenien qytetare. Kryetari Ilazi shprehu angazhimin e tij dhe të stafit për përkushtimin e madh për zbatimin e projekteve komunale të planifikuara për realizim për vitin 2020, ku janë të përfshira të gjitha komunitetet pa dallime. Kryetari Ilazi falënderoi të gjithë partnerët dhe bashkëpunëtorët komunalë gjatë vitit 2019, ndërsa uroi për bashkëpunime të mira e të mbara edhe në vitin 2020", ka njoftuar Komuna e Kaçanikut.

Limani: Biblioteka 'Fan S. Noli' pati 59 mijë lexues në vitin që lamë pas

GJILAN, 6 JANAR (ER) - Vit të suksesshëm e ka paraqitur vitin që e lamë pas ushtruesja e detyrës së drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport, Deniza Limani, duke thënë se falë bashkëpunimit me të gjithë aktorët ka arritur t'i realizojë në përpikëri planifikimet. "Gjatë këtij viti janë mbajtur qindra aktivitete kulturore, sportive dhe për rininë e Gjilanit, me një numër impresionant të qytetarëve që na kanë ndjekur", ka thënë Limani në konferencën për gazetarë.

Limani ka theksuar se në bibliotekën e qytetit 'Fan S. Noli' në vitin 2019 janë regjistruar 4 433 anëtarë të rinj, mbi 59 mijë persona kanë qenë lexues dhe shfrytëzues të sallave të leximit, ndërsa mbi 35 mijë libra janë huazuar. "Po ashtu, janë promovuar 21 autorë, në mesin e tyre edhe autorë të huaj", ka deklaruar Limani. Ndërsa sa i përket teatrit të qytetit, Limani



ka thënë se me vetë faktin se kryetari Lutfi Haziri e ka shpallur për Drejtorinë për Kulturë,

Rini dhe Sport si drejtorinë e vitit 2019, tregon se ka qenë një storie e suksesit.

Nis ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Junik

JUNIK, 6 JANAR (ER) - Komuna e Junikut ka njoftuar se ka filluar ndërtimi i kanaleve të ujitjes në lokacionin Jazina - Prita e Katunit, i cili ka për qëllim rregullimin e infrastrukturës, duke u ofruar qytetarëve kushte të përshtatshme për zhvillim të bujqësisë. Ky projekt është

duke u zhvilluar në kuadër të iniciativës "Shërbime të mira për zhvillim të bujqësisë dhe blegtorisë". Komuna e Junikut ka bërë me dije se ky projekt është duke u realizuar nga kjo komunë dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.



Rijeka dhe Galway, kryeqytetet e kulturës për vitin 2020

Atmosfera melankolike, rustikale dhe peizazhe të pafundme. Rijeka në Kroaci dhe Galway në Irlandë mbajnë në vitin 2020 titullin e "kryeqytetit evropian të kulturës"

Në kryeqytetin kulturor të këtij viti, Plovdiv, tabelat e informacionit dhe banderolat e reklamave po largohen gradualisht nga peizazhi i qytetit. Rijeka në Kroaci dhe Galway në Irlandë janë në fillesat e tyre. Deri tani për turistët nuk ia ka vlejtur të ndaleshin në Rijekë, shumica vetëm kalonin rrëmbimthi rrugës për në Opati dhe qytete të tjera tipike piktoreske të Adriatikut. Sepse Rijeka nuk ka plazh tërheqës me shezlongje dhe çadra shumëgjyreshe. Por qyteti nuk ka nevojë për to, sepse sharmi i tij qëndron diku tjetër. Rijeka është një pikë-takim mes Evropës Qendrore dhe Juglindore. Qyteti port me fortesat mesjetare, pallatet madhështore nga koha e Habsburgëve, tregjet në stilin Art Nouveau, piacat italiane, ndërtesat e parafabrikuara socialiste dhe fabrikat e braktitura, që duan të ringjallen përsëri, e kujt i duhet këtu plazhi?

Rijeka, dëshmitare e epokave

Deri në Luftën e Parë Botërore Rijeka i përkiste Monarkisë Austro-Hungareze, nga viti 1924 deri më 1945 pjesa më e madhe e qytetit ishte nën sundimin italian. Pasoi shteti multietnik i Jugosllavisë, në të cilin Rijeka u shndërrua në një qytet model socialist me kantieri, rafineri dhe fabrika. Popullsia u rrit nga 25 000 në 200 000 banorë. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë shumë industri u mbyllën, fabrikat u shndërruan në ambiente apokaliptike. Shumë njerëz mbetën pa punë, ajo që mbeti ishte sektori i shërbimeve dhe

migracioni. Sot në Rijeka jetojnë ende 130 000 veta.

Ta shndërrosh të vjetrën në të re

Rijeka ka marrë gjithsej 40 milionë euro nga fondet e BE-së për vitin e ardhshëm. Por ndryshe nga kryeqytetet e tjera kulturore qyteti në gjirin e Kvarnerit nuk do të ndërtojë godina të reja. Rijeka e ka ruajtur të vjetrën dhe e kthen atë në të re. "Ndërtesat industriale të braktitura janë pjesë e identitetit të qytetit, ato kanë vlerë narrative, për këtë arsye kemi vendosur të mos i rrëzojmë ato, por t'i ridizajnojmë", thotë Irena Kregar Shegota, shefe e komunikimit për "Rijeka 2020". Si për shembull ish fabrikën "Rikard Bençiq" në Rrugën Kreshimirova në Rijekë: në arealin e braktisur prej 27 000 metrash katrorë do të gjejnë tani strehë katër institucione të reja kulturore.

Edhe anija "Galeb" (në shqip "pulëbardha"), dikur anije ushtarake dhe mallrash, më vonë jahti i Titos, do të shndërrohet në muze. Projekti i qytetit është pritur mirë nga turistët, por jo nga disa banorë. "Disa e identifikojnë këtë anije vetëm me Titon dhe Jugosllavinë dhe janë skeptikë se si do të portretizohet ky kapitull i historisë sonë, por qëllimi ynë është të tregojmë tërë historinë e anijes, e cila filloi shumë kohë para Titos dhe është shumë interesante. Dhe përveç kësaj ne besojmë se anija si muze mund të ishte një atraksion i preferuar turistik dhe për këtë arsye një burim i mirë të ardhurash për qytetin", thotë Irena Kregar Shegota.



E hapur, tolerante dhe multikulturore

Skena e gjallë kulturore e Rijekës tërheq shumë profesionistë të lirë dhe njerëz që e duan lirinë. Rijeka gjithmonë ka qenë dinamike dhe përparimtare. Ajo është vendlindja e muzikës punk në Kroaci me grupet muzikore si "Paraf" dhe grupin e parë të muzikës rok në ish-Jugosllavi, "Uragani". "Porti i diversitetit" është motoja, që i ka dhënë vetes Rijeka. Porti është porta drejt botës përmes së cilës kanë ardhur shumë kombësi, kultura dhe fe. Ata e bëjnë Rijekën një qytet shumë të veçantë. Ndryshe nga Kroacia shumë konservatore, Rijeka është më tolerante, më e hapur, më e lirë. Festivali i LTGB "Smoqua" zhvillohet këtu pa incidente. Nuk është kështu në pjesët e tjera të vendit, ku forcat e krahut të djathtë po rimarrin hov. "Rijeka është një qytet tolerant, që jo vetëm i pranon dallimet, por edhe i jeton ato. Ne jemi gjithashtu qyteti i parë në Kroaci, i cili është pjesë e rrjetit të Këshillit të Evropës 'intercultural cities', 'qytetet ndërkulturore'. Kjo është arsyeja pse kemi zgjedhur moton 'porti i diversitetit'. Këtë moto ne e shtrojmë

pyetje për Evropën: Sa është e gatshme Evropa të pranojë dallimet?", pyet Irena Kregar Shegota.

Galway, 'Si Barcelona, vetëm në shi'

Një rrugë fshati në plan të parë, në sfond male dhe një çap, që shikon i çuditur në kamera. Kështu prezantohet qyteti Galway në internet. Natyrë e pastër. Për kulturën duhet të shkosh pak më poshtë. Dhe atëherë sheh muzikë, valle, letërsi, poezi. Ka diçka për secilin. Qyteti i vogël universitar me gati 80 000 banorë ndodhet në bregdetin perëndimor të Irlandës, në fund të Evropës, me pamje nga Oqeani Atlantik. "Amerika është ndalesa tjetër", thotë drejtoresha kreative Helen Marriage gjatë prezantimit të programit kulturor. Galway konsiderohet bastioni i muzikës tradicionale irlandeze: muzikantë në rrugë luajnë në çdo cep pavarësisht motit të keq. "Galway është si Barcelona me shi, sepse këtu bie shi 240 ditë në vit", thotë Helen Marriage. Dhe nëse nuk e përballoni dot specialitetin lokal, "shiun e vazhdueshëm", ndaloni thjesht në pijetoren

tjetër. Ato janë të panumërta dhe atmosfera është gjithmonë gazmore, me pijet lokale dhe me muzikën krijohet një atmosferë e mirë.

Kryeqyteti evropian i kulturës në kohën e Brexitit

Galway ndodhet rreth 160 kilometra larg kufirit me Irlandën e Veriut. Kjo i zë njerëzit, sepse Britania do të largohet nga BE-ja në fund të janarit dhe shumë kanë frikë nga rigjallërimi i konfliktit me Irlandën e Veriut, në të cilin kanë humbur jetën mijëra dhe dhjetëra mijëra janë plagosur. "Festivali vjen në kohën e duhur. Ne kemi nevojë për kulturë më shumë se kurrë", thotë ambasadori irlandez në Londër, Adrian O'Neill. "Ai mund të ndryshojë qëndrimet". Shpresat janë të mëdha se titulli i kryeqytetit evropian të kulturës do të ndihmojë në zbutjen e tensioneve në ishullin irlandez për shkak të Brexitit. Përgatitjet për hapjen vazhdojnë: Era do të ulërijë gjatë hapjes dhe do të bjerë shi, thotë drejtorja krijuese Helen Marriage, "por do të jetë një kënaqësi e madhe". Pra mos u frikësoni nga aplikacioni i motit. (DW)



Trumpi kërcënon Irakun me sanksione nëse dëbohen forcat amerikane

Presidenti Trump u tha gazetarëve se ShBA-ja ka një bazë ajrore jashtëzakonisht të shtrenjte që kushton miliarda dollarë duke kërcënuar me sanksione çfarë nuk i kanë parë kurrë më parë, nëse Shtetet e Bashkuara nuk janë në gjendje të largohen miqësisht nga Iraku

Uashington, 6 janar - Presidenti amerikan, Donald Trump, tha se Shtetet e Bashkuara nuk do të largohen nga Iraku, përderisa nuk shpaguhen për një bazë ajrore të ndërtuar atje. Ai i bëri këto komente duke reaguar ndaj rezolutës së miratuar nga Parlamenti irakian, i cili i kërkoi të dielën qeverisë të largojë 5 mijë e 200 trupat amerikane që ndodhen aty. Presidenti Trump u tha gazetarëve në avionin presidencial të

dielën se Shtetet e Bashkuara kanë një bazë ajrore "jashtëzakonisht të shtrenjte" që kushton miliarda dollarë. "Ne nuk largohemi derisa ata nuk paguajnë", tha ai duke kërcënuar me sanksione "çfarë nuk i kanë parë kurrë më parë", nëse Shtetet e Bashkuara nuk janë në gjendje të largohen "miqësisht" nga Iraku. Shtetet e Bashkuara përdorin 12 objekte të ndryshme ushtarake gjithandej Irakut. Presidenti

Trump nuk e saktësoi se për cilën bazë po fliste. Parlamenti irakian kërkoi largimin e trupave amerikane, në shenjë proteste ndaj sulmit me dron në aeroportin e Bagdadit, që vrau gjeneralin iranian Qasem Soleimani. Shumica shiite në parlament votoi për rezolutën nëpërmjet së cilës i bëhet thirrje qeverisë t'i japë fund marrëveshjes dypalëshe me koalicionin e udhëhequr nga SHBA-ja që parashikon qëndrimin e trupave në tokën irakiane. Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo u shpreh skeptik se forcat amerikane do të dëboheshin. Ai tha për rrjetin televiziv "Fox News" se "Uashingtoni ka besim se populli irakian dëshiron që Shtetet e Bashkuara të qëndrojnë atje". Zëdhënësja e Departamentit të Shtetit, Morgan Ortagus, tha Shtetet e Bashkuara janë të zhgënjyera nga vendimi i Irakut dhe po presin sqarimin e ligjsh-

mërisë së vendimit. Ajo tha se Shtetet e Bashkuara i kërkojnë Irakut të ndryshojë qëndrimin e tij. "Ne besojmë se është në interesin e përbashkët të Shteteve të Bashkuara dhe Irakut që të vazhdojnë të luftojnë ISIS-in bashkërisht. Kjo administratë mbetet e përkushtuar për një Irak sovran, të qëndrueshëm dhe të përparuar", tha ajo. Shtetet e Bashkuara dhe Iraku, ranë dakord për rikthimin e trupave amerikane në Irak katër vite më parë për të ndihmuar në luftën kundër terroristëve të Shtetit Islamik. Kjo ndodhi pas tërheqjes së të gjitha forcave amerikane që kishin ndërhyrë në vitin 2003 për rrëzimin e diktatorit irakian Saddam Hussein. Rezolutat e Parlamentit irakian nuk janë detyruese. Por, kryeministri në detyrë Adel Abdul Mehdi, i kishte kërkuar Parlamentit më herët që të merrte masa urgjente dhe t'i jepte fund pranisë së trupave të huaja sa

më parë që është e mundur. Por, ai tha se çdo vendim rreth trupave amerikane duhet të ketë parasysh që interesat kombëtare dhe siguria e Irakut nuk do të dëmtohen. Riyadh Muhammad Ali Al Masoudi, anëtar i parlamentit irakian, i tha shërbimit kurd të "Zërit të Amerikës" se nuk duam të krijojmë një boshllëk politik ose të sigurisë në këtë drejtim. Ajo që ne duam me të vërtetë, është të ruajmë sovranitetin e Irakut dhe të ardhmen politike të vendit. Ne shpresojmë se kjo marrëveshje do të shërbejë në interes të Irakut dhe nuk do të përdoret kundër Irakut. Ndërkohë, udhëheqësi i Hezbollahut pro-iranian në Liban, Sheiku Hassan Nasrallah, mbajti një fjalim të zjarrtë para përkrahësve të tij në Bejrut, duke i kërkuar Parlamentit irakian të dëbojë Shtetet e Bashkuara, ndërsa ngul këmbë për hakmarrje pas vrasjes së Soleimani.



Von der Leyen: Zbutja e tensioneve në interes të Iranit dhe Irakut



Berlin, 6 janar - Presidentja e Komisionit European, Ursula von der Leyen tha të hënën se zbutja e tensioneve mes Teheranit dhe Uashingtoni, pas vrasjes së gjeneralit iranian Qasem Soleimani është në interes të Iranit dhe Irakut. "Është në interes të Iranit dhe veçanërisht të Irakut, që të zgjedhin rrugën e maturisë dhe jo të përshkallëzimit", deklaroi von der Leyen në një takim të konservatorëve bavarezë të CSU-së në Seon. Ajo konfirmoi, gjithashtu, edhe mbajtjen e një takimi të

jashtëzakonshëm të ministrave të jashtëm evropianë të premten, ndërkohë që BE-ja kërkon t'i zbusë tensionet pas vdekjes së Qasem Soleimani, i vrarë gjatë një sulm amerikan në Bagdad. Edhe kreu i diplomacisë gjermane, Heiko Maas theksoi se kërcënimet e presidentit amerikan, Donald Trump për të sanksionuar Irakun nuk janë një ndihmë e madhe. "Nuk mendoj se mund të bindet Iraku me kërcënime, por më shumë me argumente", nënvizoi Maas për

radion publike "Deutschlandfunk". "Në Irak, ne jemi shumë të angazhuar, jo vetëm në aspektin ushtarak, por gjithashtu edhe në ndihmë për stabilizimin, në mënyrë që të rindërtojmë këtë vend, të krijojmë infrastrukture", nënvizoi ai. "E gjithë kjo rrezikon të jetë e humbur, nëse situata vazhdon të zhvillohet në këtë mënyrë", theksoi Maas, i cili dëshiron të sigurohet që Iraku të mos bëhet skenë e një lufte mes vendeve të tjera, ShBA dhe Iran.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
[Listed in alphabetical order]
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



Përkujtohet aktori Sandër Prosi në 100 vjetorin e lindjes së tij



Më 6 janar të vitit 1920 lindi në Shkodër, Sandër Prosi, i cili do të bëhej më vonë një prek aktorëve ikonë të filmit dhe teatrit shqiptar, personazhet e të cilit kanë mbetur në kujtesën e brezave dhe në arkivën e artë të kinematografisë. Teatri Kombëtar në një kujtesë me rastin e 100-vjetorit të lindjes

së artistit të madh, sjell edhe datat kryesore që shënuan jetën e tij. Pasi mbaroi shkollën fillore vazhdoi gjimnazin e Tiranës. Merr pjesë në dramën "Vilhelm Teli". Shkon për studime në Austri për dentist, të cilat nuk i mbaroi. Më 1947 merr pjesë në konkursin pranë Teatrit Popullor dhe e fiton

atë. Që këtu fillon dhe veprimtaria e tij e gjerë dhe e larmishme artistike. Sandër Prosi bën pjesë ndër ata aktorë ndihmesa e të cilëve është e lidhur me krijimin e artit tonë profesionist të skenës dhe ekranit, si dhe me arritjet e tyre më të shënuara. Ky aktor krijoi mbi 85

role në 75 vepra të autorëve tanë si A.Z. Çajupi, K. Jakova, B. Lëvonja, L. Papa, I. Kadare, T. Laço, R. Pulaha, D. Agolli, Dh. Xhuvani dhe të autorëve të huaj si Shekspiri, Shileri, Çehovi, Karaxhale, Gorki, Brehti etj. Interpretoi në rreth 30 filma, ku krijoi role të tilla që kanë hyrë në

fondin e qëndrueshëm të teatrit dhe kinematografisë tonë. Për ndihmesën e tij të madhe në zhvillimin e artit tonë skenik e kinematografik ai është nderuar me titullin e lartë "Artist i Popullit", me Çmime të Republikës dhe me urdhëra e medalje. /atsh

Vigjilenca Abazi, shqiptarja që botoi libër në Universitetin e Oxfordit

Pa dyshim që të rinjtë shqiptarë janë duke arritur suksese të mëdha në botë, jo vetëm në fushën e muzikës dhe të sportit, por edhe në atë akademike. E patjetër njëra nga këto është 27-vjeçarja shqiptare nga Shkupi, Vigjilenca Abazi.

Edhe pse Abazi është vetëm 27 vjeçe, ka një biografi të jashtëzakonshme, thaujse të pamundur për një person të moshës së saj.

Sipas informacioneve, thuhet se ajo tani është anëtare e 'Emile Noel' në Fakultetin Juridik në Neë York dhe asistente në Universitetin e Mastrihit.

Po ashtu, vlen të theksohet se ajo ka doktoruar në Universitetin e Amsterdemit dhe ka qenë një bursiste e Fulbright në Kolegjin e Ligjit të Kolumbias.

Gjithashtu, Abazi ka qenë edhe këshilltare e Këshillit Evropian dhe pjesë e ekipit të autorëve që kanë shkruar direktivën për

mbrojtjen e informatorëve të Bashkimit European.

Ajo aktualisht është anëtare udhëheqëse e bordit të shumë revistave shkencore akademike dhe se ka më shumë se njëzet botime shkencore, duke përfshirë edhe librin të botuar edhe për Universitetin e Oxfordit, "Sekretet zyrtare dhe mbikëqyrjen në BE", transmeton KultPlus.

Ky libër do të jetë një referencë për të gjithë ata që do të arsimohen në universitetet më të mira të botës. Abazi ka qenë e ftuar të ligjerojë në Universitetin e Oksfordit, Harvard Laë School, Universitetin e Kolumbias, NYU (Paris, Firenze, Abu Dhabi).

Ajo gjithashtu është ftuar të prezentojë kërkimet e saj në Parlamentin European dhe Parlamentin Holandez. Vigjilenca është shprehë se në të ardhmen do të donte të transferonte përvojën e saj në Maqedoni dhe të investonte njohuritë e saj në vendin ku ajo lindi. /albinfo



Historia e një fotografie dhe një takimi në Paris: Sartre, Beauvoir, Steinberg dhe Gjon Mili

Në një fotografi të realizuar në Paris, në shtator të vitit 1946, brenda një dhome shihen ulur tri personalitete të njohura të artit e të kulturës botërore, ndërkohë që i katërti po fotografonte

I pari në anën e majtë të kompozicionit fotografik – dhe më afër fotografit – duket filozofi, dramaturgu, skenaristi, novelist, aktivisti politik, biografi dhe kritiku letrar francez Jean-Paul Sartre, që rri ulur pranë tavolinës së punës me një grumbull letrash para e duke e mbajtur një stilograf në dorën e djathtë – mes gishtit tregues dhe gishtit të mesëm. Filozofi botërisht i njohur, portreti i të cilit duket vetëm në profilin e tij të djathtë, mban syze me korniza të rrumbullakëta, ndërsa në buzë ka të varur një cigare të markës franceze “Gauloises Bleues” – pakoja e së cilës rri e hapur mbi tavolinë. Shikimi i tij prej mendimtari rri i fiksuar diku në ndonjë pikë të dhomës, përballë tij, kurse rudhat e theksuara mbi ballin e filozofit zbulojnë lodhjen dhe rraskapitjen intelektuale e shpirtërore.

Në krahun e majtë të Sartrit, ulur në një kolltuk lëkure pranë

dritares së madhe me perde të mbledhura anash dhe me kangjella të bukura nga ana e jashtme, rri gruaja e tij e jetës: shkrimtarja, intelektualja, filozofja ekzistencialiste, aktivistja politike, feministja dhe teoricienja sociale franceze Simone de Beauvoir. Fotografia atë e zuri me gotë në buzë, por me shikim drejt tij.

Personi i tretë në këtë fotografi interesante dhe të bukur, që rri ulur në një karrige përballë fotografit duke shikuar drejt në të, është karikaturisti dhe ilustruesi i njohur rumun-amerikan, Saul Steinberg, i cili me bashkëshorten Heda atë fundvere udhëton nga Nju-Jorku për në Paris vetëm për ta njohur Sartrin. Steinbergu, i cili, po ashtu, mban syze me korniza të rrumbullakëta, i mban këmbët kryq dhe mbi gjurin e djathtë ka një bllok vizatimi ku duket se po e vizaton Milin (ky vlerësim vjen për një arsye të fortë, të cilën do ta



përmendi pak më vonë në këtë shkrim).

Si ndodhi që fotografi shqiptaro-amerikan me famë botërore, Gjon Mili, të jetë mysafir në shtëpinë e filozofit të njohur francez, shtëpi të cilin e kishte blerë rishtas në lagjen e njohur parisienne “St. Germain” (menjëherë pas kthimit nga turneu ekzistencialist në ShBA, ku kishte fituar para të majme nga ligjëratat e shumta nëpër universitetet amerikane dhe për-mes artikujve të shkruara nga atje për gazetatat e revistat franceze)?

Mili i kishte dy arsye të forta për të shkuar në Paris në fund të shtatorit 1946.

Arsyeja e parë kishte të bënte me detyrën që redaktori i revistës “LIFE” ia ngarkoi: që në tetor të atij viti t’i ndiqte punimet përfundimtare të Konferencës së Paqes, ku temë kryesore ishte zbutja e armiqësisë dhe arritja e paqes mes dy superfuqive botërore, BRSS-së dhe ShBA-së (në këtë konferencë ka marrë pjesë edhe kryeministri komunist shqiptar, Enver Hoxha, të cilit Mili arriti t’ia realizonte një portret nga distanca).

Arsyeja e dytë ishte organizimi i ekspozitës së tij të parë në kryeqendrën franceze dhe në përgjithësi në Evropë, që do të qëndronte e hapur në “Galerie du Bac” nga 1-10 tetor 1946. Ekspozita, siç shkruan në pjesën e brendshme të katalogut, u organizua nga shërbimet sekrete të Francës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Mili kishte dëgjuar për Sartrin

gjatë vizitës së tij të bujshme në ShBA, një vit më herët (1945), ndërsa tash që gjendej në qytetin e tij, donte t’ia realizonte ndonjë portret. Takimi mes dy gjenive të kohës ishte shumë miqësor dhe frytdhënës.

Sartri u mrekullua me artin fotografik të Milit, veçmas me serinë “Dancers in Movement” (Vallëzuesit në lëvizje), të realizuar me teknikën inovative të stroboskopisë – ndaj vendosi ta shkruajë fjalën inauguruese të ekspozitës së tij! Mili u entuziazmua pa masë me këtë njoftim, sepse ishte nder i jashtëzakonshëm që shkrimi i filozofit më në zë të asaj kohe të vendosej në katalogun e ekspozitës dhe se me të do të bëhej paraqitja e parë para publikut parisien.

Nuk duhet lënë pa përmendur se kopertina e këtij katalogu katërfaqësh u ilustrua me karikaturën e Saul Steinbergut, ku shihej Gjon Mili duke fotografuar dy valltarë.

Në vazhdim po ua ofroj shkrimin e Sartrit, që përmbledh më së miri karakterin krijues të Gjon Milit:

“Mili ka kokë si të dashit; e ka një hundë me të cilën e nuhatë botën para tij e që, papritmas, duket sikur do ta fusë në një grumbull milingonash. E pastaj, ndër atë hundë, shumë më thellë, shihen ato pak mustaqe. Me pjesën tjetër të fytyrës – të syve dhe të mollëzave, të flokëve të shpupurishur – më tepër i ngjason një banditi malazias. Gjithsesi, është gjuetar dhe grabitqar. Para se ta takoja, i njihja veç fotografët anemikë që fotografojnë plot dëshpërim vrasjen e dikujt.

Mili nuk ka naze; preferon çdo gjë: ushqimin, pijen, vallëzimin;

Harlemin e njej më mirë se çdo i bardhë tjetër; Nju-Jorkun më mirë se çdokush tjetër.

Duket i lumtur. Nuk dëshiron të vrasë, por edhe më keq: ai të do të gjallë. Në portretet tuaja më të mira dukeni i vdekur dhe i balsamuar; i ruajtur në hiposulfat, ashtu siç në fund do t’ju ndryshojë përjetësisht.

Mili të kapë të gjallë, në gjendje të ngurtësuar; ti vazhdon të përpëlitesh në fotografinë e tij, mu si peshku në rrjetë; si zhongleri i jashtëzakonshëm dhe i gjatë, që e vazhdon melankolinë për ta kom-pozuar imazhin me topat që dalin si në gjysmë lëvizje, që duken si llum e ndonjëherë si baltë plotësisht e tëholluar; apo si valltarët e zinj të vendosur në një kafaz që kot hidhen lart për të dalë nga aty; ose si ajo gruaja lakuriq që duket se shihet nga mijëra sy të një mize.

Ai është një burrë që të kurthon: për t’ju nxjerrë nga zona e mbrojtjes, përdor marifete prej prestigjatori.

Nuk mjaftohet të fotografojë njerëz të famshëm, sepse ai bën që secila fotografi të jetë një provë: sipas tij, ka po aq mënyra për t’u fotografuar sa ka edhe njerëz. Nëse viheni në këtë lojë, jo vetëm që do t’ju gozhdojë për së gjalli në koleksionin e tij, por madje do t’ju sodisë. Do t’ju njohë: pa dyshim, do të dorëzoheni dyfish në duart e tij.

Primitivët e Deteve të Jugut (Paqësori jugor – v. j.) thonë se nuk duan të fotografohen, sepse u duket sikur kapen e robërohen përgjithmonë. Shikojeni foton e Molotovit të shkrepur nga Mili dhe do ta kuptoni urtësinë e tyre”.

Jean-Paul Sartre /Revista “Akademia”



Jean-Paul Sartre, Simone de Beauvoir dhe Saul Steinberg (Fotografinë: Gjon Mili, 1946)

E rrallë

Kinë, ndërtohet një qytet i tërë prej akulli, nis në Harbin festivali i dëborës

Në qytetin kinez të Harbin, kryeqendra e provincës verilindore të Heilongjiang, nga 5 janari i viti 1984 mbahet festivali ndërkombëtar i akullit dhe dëborës. Çdo vit një qytet i tërë merr formë me gratacela, kështjella dhe evente për turistët.



FOTO E DITES



Në fotografi shihet një ushtar i Republikës së Shqipërisë nga Batalioni Komando.

E jashtëzakonshme

Japoni, peshku ton në ankand për 1,5 milion euro

Pronari japonez i një rrjeti restorantesh sushi, i ashtuquajtur 'Mbreti i peshkut ton', ka fituar çmimin e tonit më të madh në tregun e Tokios, me një milion e gjysmë euro, në ankandin e Vitit të Ri. Kiyoshi Kimura, pronar i restoranteve Zanmai, është në krye të kronikave për blerjen



rekord prej 193 milionë yenësh, për një ton të kuq që peshon 276 kilogramë, i peshkuar edhe këtë vit në brigjet e prefekturës së Aomori (në veri të Japonisë).

BARSOLETA E DITËS



Burri pyet gruan: Çfarë ka për drekë?
Gruaja: S'ka asgjë.
Burri: Edhe mbrëmë asgjë, edhe sonte asgjë.
Gruaja: Kur gatuj, gatuj që të ketë për dy ditë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min
Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.
Regjia: Conrad Vernon and Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min
Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.
Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.
Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30
TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI
 Ndoshka nuk ka asgjë për t'u

shqetësuar, por duhet të tregoheni të kujdesshëm. Njerëzit po tërhiqen nga energjia juaj tani.



DEMI
 Shumë nga këto gjëra ndihen të domos-

doshme nga një këndvështrim emocional, por nga një këndvështrim realist.



BINJAKËT
 Ju jeni të gatshëm ta balanconi karrierën

me jetën tuaj personale, gjë që do t'ju krijojë mundësi shumë interesante për ju.



GAFORRJA
 Sigurisht, ju mund të kapeni me disa detaje

të gabuara, por kujtesa juaj ka një mënyrë qesharake për të luajtur apo argëtuar.



LUANI
 Çdo blerje që ju bëni sot mund ta ndikojë

llogarinë tuaj bankare. Kurseni paratë tuaja për një ditë tjetër dhe mos merrni ndonjë rrezik financiar.



VIRGJËRESHA
 Ndërkohë që i zbuloni gjërat ashtu

siç janë në të vërtetë, nuk mund të ecni përpara dhe t'i kushtoni vëmendje të plotë dikujt që nuk meriton aspak kohën dhe dashurinë tuaj.



PESHORJA
 Për një harmoni më të madhe në

ditën tuaj, mos u përpiqni të përputheni me atë lloj energjie.



AKREPI
 Ne po flasim për informacione të

brendshme, komente lajkuese, madje edhe një sekret. Mprihni veshët dhe përgatituni për t'u argëtuar dhe befasuar.



SHIGJETARI
 Mendja juaj është akoma shumë

aktive, kështu që mos u shqetësoni për humbjen e energjisë tuaj ose për të rënë nën magjinë e shtratit tuaj.



BRICJAPI
 Jini kreativ dhe shiheni situatën në këndvështrime

të ndryshme. Shkrimi i një letre dashurie, ose akoma më mirë një këngë dashurie, do t'ju tregojë atyre se nuk jeni si të gjithë të tjerët.



UJORI
 Një përmbledhje duhet t'i zbulojë të

gjitha gabimet që mund të gjenden atje. Thjesht merrni pak kohë shtesë për t'u siguruar që gjërat janë në rregull.



PESHQIT
 Në kohën tuaj të lirë, rrii ulur dhe

shikoni botën të kalojë. Personat që shihni do të sjellin argëtim, konfuzion dhe stimulimin që ju nevojitet.

Rebel Wilson mblodhi 100 mijë dollarë për zjarret në Australi



Aktorja e njohur Rebel Wilson ka mbledhur 100 mijë dollarë për ta ndihmuar Australinë që është përfshirë nga zjarret tash e disa javë. Ajo i ka ftuar në rrjete sociale adhuruesit që ta ndihmojnë


të mbledhë para. Ajo e ka organizuar në shtëpinë e saj një drekë ku janë ftuar shumë afaristë dhe persona të njohur për të dhënë para për fondacionin e hapur për të prekurit nga zjarri në Australi.

Filmi për Luftën e Parë Botërore "1917" fiton çmimin e parë në Golden Globes



Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve Golden Globes filmi për Luftën e Parë Botërore "1917" është vlerësuar me çmimin kryesor si drama më e mirë. Ky film,

me regjisor Quentin Tarantino, ka fituar tre çmime deri tani, duke shpresuar për fitoren në ceremoninë e ndarjes së çmimeve Oscar muajin e ardhshëm.



Halle Berry e mban veten në formë me ushtrime

Ajo është një nga supermodelueset më të famshme në botë. Për të qëndruar gjithmonë në formë, Halle Berry shkon rregullisht në fitnes. Berry së fundmi ka ndarë, përmes rrjeteve sociale, fotografi për fansat ku shfaq linjat tru-

pore tejet seksi. "Ju faleminderit që keni qenë bashkë me mua në këtë platformë. Vlerësoj çdo ndjenjë të posaçme të cilën e kam marrë nga të gjithë ju. Gëzuar 2020-ta!", ka shkruar ajo në "Instagram".

Pushimet "nuk kanë fund" për Obamën



Për ish-presidentin e ShBA-së, Barack Obama, ky vit ka nisur mjaft i qetë. Edhe pse u zhvendos që para Krishtlindjeve në HaWaii, Obama vijon t'i shijojë mrekullitë e atij vendi, duke mos i

ndalur pushimet. Ai u fotografua duke bërë sërf. Familja Obama u zhvendos me një aeroplan privat në Hawaii më 16 dhjetor, në vendlindjen e tij. Më herët ai është parë edhe duke luajtur golf.



| | | Autor: GAZMEND MORINA | KËNGËTARJA AMERIKANE NË FOTO (shqip.) | SHUMË, TEJ MASE | PIKA MË E LARTË NË KUPËN E QIELLIT (pashq.) | UNIVERSITY LANCASTER OHIO | TINARI | EPOKA ERE | SHTËPIZA E NDËRTUAR ME DËRRASA | ZANORE | GUR I ÇMUAR ME NGJYRË TË KALTËR OSE TË GJELBËR | PIANISTJA LULE | KËNGËTARJA MUÇAJ |
|--|------------------------------------|---|--|--|---|---|---|---|---|---|--|--|--|
| | | | ○ | | | | | PELLG I HAPËT PËR TË GRUMBULLU- AR UJË BASHKËT. | | | | | |
| | | | ○ | | | | | | | PËRGJIGJE NË TELEFON E GDHENDA | | | |
| | | | ○ | | | | | ARBITËR BEREQET | | | | | |
| | | | ○ | | | METODË STUDIMI PËRSHTATJE (sh.shq.) | | | | | | | |
| | | | ○ | | | | FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË SHTET FEDERAL NË SHBA | | | | | | QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE |
| | | | ○ | | THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.) "KENIA" | | | | | | GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.) | ZANORE GAZ QË SHPËRTHEN KUR DIKUSH TALLET ME DIKË | |
| | | | ○ | PJESË E FORTË E BUKËS "RISANI" | | | | | LLOJ BIME ME TË CILAT BEJMË PILAF | | | | |
| EPOKA ERE | LOJ PËLHURË E TRASHË SI STOF | QË I MOHON NORMAT E MORALIT | AKTORJA E FAMSHME ANDERSON | VESHJE E SIPËRME PREJ SHAJAKU LLOJ LOJE FATI | MURG I VETMUAR AMPER, RENIUM | | | | | DALLGA SHOK | | | |
| DAMARI I GJAKUT | | | | | | | | OLIVIA ZUMWALT INSTITUTE DEFENSE ANALYSES | | | TENISTI SAFIN BASHKËT. | | |
| DILETANTI | | | | | | | IDHULLI KËNGËTARJA LIBOHOVA | | | "IRLANDA" KËNGËTARJA GANIMETE | | | GABZHERRI, GURMAZI |
| BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE QË PËRDORËT SI USHQIM | | | | | | | FUTBOLLISTI XHEKO FUTBOLLISTI SENEGALIZ ARMAND | (QPR) | | | GJAKATAR KUVENDI I KOSOVËS | | |
| AKTORJA PAPAS | | | | | KËRCELL I BIMËS SË MISRIT ZANORE | | | | | | SHKRONJË GREKE NDODHEM RASTËSISHT NË NJË VEND | | |
| DHUROJ DIÇKA | | | | RANISHTJA PËSHTJELLIM (shq.) | | | | ZANORE I AFRUAR | | GRYKË E VULLKANIT LECKA PËR ARNIM | | | |
| HOVI, VRULLI | | | | | KËNGËTARJA AMERIKANE BAKER BASHKËT. | | | | | ANGOLA, ZAMBIA ZANORE | | TITAN VAJZA E DJALIT A E VAJZËS | |
| EPOKA ERE | SHKRIMTARI HAZIRI | I PARI I MURGJVE NË NJË ABACI (pashq.) | BASHKËT. KAFSHË SHTËPIAKE ME TRUP E ME QAFË TË TRASHË | KLUB FUTBOLLI NË HOLLANDË, RADIUM, ZET | | | | HUMORISTI THAQI PJESË E ILIRISË | | | | | BASHKËT. SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË (bised.) |
| RADIOLOK- ATOR | | | | | BIMË E CILA PËRDORËT PËR USHQIM RAPSODI BERISHA (shq.) | | | | | BASHKËT. ROMANCIERI GJERMAN ERIK MARIA | | KËNGËTARJA JONË '... MAMA' | |
| LIBËR FILLESTAR | | | | | | | | KAMPIONI MËSYMJE | | | | ISH FUTBOLLISTI BRAZILIAN ... GASPARI (ARSENAL) VEZAK | |
| ÇMENDURI; BUDALLA- LLËK | | | | | | BABAI AMERICAN TEATRE ORGAN SOCIETY | | | | E BITISA I NDESH | | | VEZË PESHKU (shq.) |
| ARTIOLA TOSKA | | | BASHKËT. BUILDING INFORMATION MODELING | REGJISTRIM NË FUTURE I ÇMIMIT TË NJË MALLI SIENA | | | | | | | KAPI DIÇKA TE PJESA E SIPËRME NË NJË GOZHDE TEXAS EDUCATION AGENCY | | |
| BASHKËT. | | BESËLIDHËS RAMADAN AVDIU | | | | | | | | | | | ERNEST KOLIQI AFËRDITA DRESHAJ |
| KLUB FUTBOLLI NË GREQI | | | | | BASHKË, ME TOTENHAM | | | SHTRATI QË PËRDORËT PËR TË MBARTUR TË SËMURËT BASHKËT. | | | | | BASHKËT. ZANORE |
| PËSHPËRIT DIKUJT FJALË MAGJIKE | | | | | | | MBULESA QË E VË DIKUSH NË FYTYRË PËR TË MOS U NJOHUR NGA TË TJERËT | | | | DËSHIROJ | | |

Homazh për Albert Camus nga Jean-Paul Sartre



Gjashtë muaj më parë, madje edhe dje, njerëzit pyesnin të interesuar: “Ç’do të bëjë ai?” Përkohësisht, i dërrmuar prej kontradiktave që duhen respektuar, ai kishte vendosur të heshtte. Por ai ishte ndër ata njerëz të rrallë, për të cilët ia vlen të presësh, pasi ata nuk nxitohen të zgjedhin dhe i mbeten besnikë zgjedhjes që bëjnë. Një ditë ai do të fliste hapur. Ne as që do të kishim guxuar të supozonim se çfarë mund të thoshte ai. Ne mendonim se ai do të kishte ndryshuar bashkë me botën, siç ndodh me të gjithë ne; kaq mjaftonte për të qenë të vetëdijshëm për praninë e tij. Unë dhe ai ishim zënë. Një zënie nuk ka dhe aq rëndësi—edhe nëse ata që zihen nuk e shohin më kurrë njëri-tjetrin—kjo thjesht është një tjetër mënyrë e të jetuarit së bashku, pa i humbur shikimit të njëri-tjetrit në atë copë botë ngushtësisht të vogël që na ka rënë për pjesë. Kjo nuk më pengonte aspak që të mendoja për të, të ndieja që sytë e tij ishin mbi librin apo mbi gazetën që unë po lexoja dhe pyesja veten: “Ç’mendon ai për këtë? Çfarë mendon ai në këtë moment?” Heshtja e tij—të cilën, në varësi të asaj çfarë ndodhte ose të gjendjes sime shpirtërore, e shihja herë si një sjellje të kujdesshme, herë me dhimbje—ishite një tipar i së përdit-

shmes, si të nxehtit ose drita, por ishte njerëzore. Ne jetonim me mendimin e tij ose kundër tij, siç shtjellohej ky mendim në librat e tij—veçanërisht te Rënia (La chute), që është ndoshta libri i tij më i mirë dhe më pak i kuptuari. Ishte një aventurë e jashtëzakonshme e kulturës sonë, një lëvizje së cilës u përpoqëm t’i kuptonim fazat dhe rezultatit final të saj.

Në kohën tonë ai përfaqësonte shembullin e fundit të asaj aradhe të gjatë moralistësh, veprat e të cilëve përbëjnë ndoshta elementin më origjinal në letërsinë franceze. Humanizmi i tij i palëkundur, i kufizuar dhe i kulluar, i rreptë dhe sensual, frymëzoi një luftë të pasigurt kundër ngjarjeve masive dhe pa formë të kohës. Por, në anën tjetër, përmes refuzimeve të tij të vendosura, ai riafirmoi, në zemër të epokës sonë—në kundërshtim me makiavelizmat dhe idhujt e realizmit—ekzistencën e çështjeve morale.

Në një farë mënyrë, ai vetë ishte pikërisht ky afirmim i vendosur. Kushdo që i ka lexuar ose ka reflektuar mbi veprat e tij ka ndeshur me vlerat humane që ai vlerësonte fort; ai e vuri në dyshim veprimin politik. Atij ose duhej t’i shmangeshe, ose duhej ta luftoje—ai ishte i domosdoshëm për atë tension që e bën jetën intelektuale të

jetë ajo që është. Heshtja e tij, këta vitet e fundit, kishte në vetvete diçka pozitive: ky Dekard i Absurdit refuzoi ta linte terrenin e sigurt të moralit duke rrezikuar në shtigjet e pasigurta të praktikitetit. Ne e ndjemë këtë, siç ndjemë edhe konfliktet që ai mbante të fshehura, për shkaqe etike, të cilat, në vetvete, njëherësh e kërkonin dhe e dënonin revoltën.

Ne prisnim; ne duhej të prisnim; ne duhej të dinim. Pavarësisht se ç’bëri ose vendosi të bënte më pas, Camus nuk reshti kurrë së qenuri një ndër forcat kryesore të veprimtarisë sonë kulturore dhe, në mënyrën e tij, të përfaqësonte historinë e Francës dhe të këtij shekulli. Por ne ndoshta e kemi ditur dhe kuptuar itinerarin e tij. Ai i tha vetes: “Puna ime shtrihet përpara”. Tani, ajo ka marrë fund. Skandali i vërtetë i vdekjes së tij është eliminimi i rendit njerëzor nga jonjerëzorja.

Rendi njerëzor s’është gjë tjetër veçse “mungesë e rendit”—ai është i padrejtë dhe i rrezikshëm, ai përmban vrasje dhe vdekje për shkak të urisë, por të paktën ky rend është krijuar, është ruajtur ose i ka rezistuar kohës prej njerëzve. Në këtë rend do të jetonte edhe Camus. Ai njeri, gjithnjë në lëvizje, që na pyeste vazhdimisht, ishte

vetë një pyetje që kërkonte përgjigje. Ai jetoi në gjysmën e një jete të gjatë; për ne, për veten e tij, për njerëzit që e mbështesin rendin dhe për ata që e refuzojnë atë. Për të ishte e rëndësishme që ta thente heshtjen, të ishte ai që vendoste dhe që vinte në përfundime. Disa vdesin në moshë të thyer, ndërkohë që të tjerë, pa bërë kurrë thujasë asgjë, mund të vdesin në çdo minutë, pa e ndryshuar kuptimin e jetës së tyre ose vetë jetën e tyre. Por, për ne, të pasigurt në mungesë të një busulle, njerëzve tanë më të mirë u është dashur të arrijnë fundin e tunelit. Natyra e punës së një njeriu dhe kushtet e momentit historik rrallë herë kanë kërkuar kaq qartë që një shkrimtar të vazhdojë të jetojë. Aksidentin që vrau Camus-in unë e quaj një skandal, pasi ai, papritur, në qendër të botës sonë njerëzore, projekton absurditetin e nevojave tona më thelbësore. Në moshën 20 vjeçare, i prekur papritur nga një sëmundje që më pas ndikoi në tërë jetën e tij, Camus zbuloi Absurdin—mohimin e pakuptimit të njeriut. Ai u mësua me të, ai e mbajti përherë parasysht gjendjen e tij të papërbalueshme dhe ia doli. Dhe përsëri njerëzit tundohen të mendojnë se vetëm veprat e tij të para dëshmojnë të vërtetën mbi jetën e tij, pasi ky njeri invalid, i sapo

shëruar, shkatërrohet nga një vdekje e papritur që i vjen nga jashtë.

Absurdi mund të jetë pikërisht ajo pyetje që askush tani s’do të mund t’ia bëjë më atij, ajo pyetje të cilën ai vetë s’do mundet t’ia bëjë më askujt, ajo heshtje që tashmë nuk është më as heshtje, që tani është absolutisht asgjë.

Unë nuk mendoj kështu. Në momentin që shfaqet, jonjerëzorja bëhet pjesë e njerëzores. Çdo jetë që ndërpritet—edhe jeta e një njeriu kaq të ri në moshë—i ngjan një pllake gramafoni që, edhe pse e thyer, është njëherësh një jetë e plotë. Për të gjithë ata që e deshën Camus-in, ka një absurditet të papërbalueshëm në atë vdekje. Por ne duhet të mësohemi ta shohim atë vepër të lënë përgjysmë si një vepër të plotë. Për sa kohë që humanizmi i Camus-ë përmban një qasje humane ndaj vdekjes që e zuri atë në befasi, për sa kohë që përpjekja e tij krenare në kërkim të lumturisë nënkuptoi dhe kërkoi domosdoshmërinë johumane të vdekjes, ne duhet të vlerësojmë në atë vepër dhe ne jetën që është e pandashme prej saj, përpjekjen e pastër dhe trimfuese të një njeriu për të rrëmbyer çdo çast të ekzistencës së tij prej vdekjes së tij të ardhshme.

*Përktheu nga anglishtja Elena
Lula/Exlibris*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Prishtina me risi nis përgatitjet, Llapi prezanton tri transferime



Klubet elitare të Kosovës janë treguar aktive edhe të hënën, pasi janë seriozisht duke u përgatitur për sezonin pranveror. Prishtina ka filluar përgatitjet me disa risi, kurse Llapi ka prezantoi tri transferimet e reja

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 JANAR - Sezioni pranveror në IPKO Superligën e Kosovës në futboll pritet të jetë shumë interesant për faktin se skuadrat janë duke u përgatitur maksimalisht për këtë pjesë të edicionit 2019/2020. Klubi më i madh në vend, Prishtina, që pretendon rikthimin e titullit kampion në elitë, i filloi edhe zyrtarisht përgatitjet së pari në palestër, konkretisht në fitnes. Para futbollistëve janë paraqitur edhe aksionarët e klubit që kanë paralajmëruar korrektësi nga ana e tyre, derisa kanë kërkuar angazhim maksimal në garën për titullin kampion. "Futbollistët janë pritur nga aksionarët e klubit, Remzi Ejupi, Rrahman Haradini, Fikret Maqastena. Futbollistëve iu është premtuar korrektësi maksimale, sidomos financiare, ndërkohë nga ta është kërkuar, sidomos regjim strikt i disiplinës me synim të qartë të rikthimit të titullit në kryeqendër", thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Ndërsa kryetari i Klubit, Remzi Ejupi, e ka prezantuar drejtorin e ri sportiv,

Granit Begollin. "Kryetari i klubit, Remzi Ejupi, para futbollistëve ka prezantuar drejtorin e ri sportiv, Granit Begolli, i cili para lojtarëve ka premtuar se do të jetë pranë tyre për çdo kërkesë apo problem që do ta kenë", thuhet në njoftimin e klubit kryeqytetas. Ndërsa trajneri Armend Dallku dhe kapiteni Armend Thaqi kanë premtuar përkushtim maksimal drejt qëllimit të vetëm që ka klubi, titullin e kampionit.

Klubi i Prishtinës iu ka rekomanduar që të gjejnë skuadra të reja Agon Xhakës, Art Malokut, Ramush Ramadanit, Jon Bajgorës dhe Lis Ahmetit. Trajneri Dallku ka konfirmuar se sulmuesi i njohur Otto John, sipas të gjitha gjasave, do të jetë lojtar i ri i Prishtinës. John e kishte udhëhequr skuadrën e Trepçës '89 në rrugën drejt titullit kampion. "Ne stafi kemi kërkuar lojtarin e përshtatshëm jo vetëm në filozofinë tonë të lojës, por edhe që e njëjta kampionatit tonë dhe jo të gjejmë dikë që do të na merrte kohë deri në adaptim. Nuk dua lojtarë të panjohur apo që nuk i njohim rethanat e futbollit kosovar. Besoj se do t'ia arrijmë

të sjellim atë që kemi dashur dhe mund të konfirmoj se jemi afër pothuajse 95 % me Otto Johnin", ka thënë Dallku.

Aktive të hënën është treguar edhe skuadra e Llapit, e cila vetëm një ditë pas largimit të Sebinio Plakut e prezantoi zëvendësimin e tij. Bëhet fjalë për sulmuesin shkodran Jasmin Raboshta, i cili në sezonin vjeshtor e djersiti fanellën e skuadrës së Vushtrrisë. "Qendërsulmuesi shkodran Jasmin Raboshta nga dita e sotme është futbollist i Llapit. Raboshta ka nënshkruar kontratë me klubin deri në përfundim të këtij edicioni me mundësi vazhdimi edhe për një vit", thuhet në njoftimin e Llapit. 29-vjeçari ka luajtur për disa klube në Shqipëri, kurse karrierë ka bërë edhe në Turqi. Ai në karrierën e pasur futbollistike ka shënuar mbi 120 gola. Në klubin nga "Zahir Pajaziti" të hënën janë prezantuar edhe Nertil Hoxhaj dhe Franci Lena. Hoxhaj ishte pjesë e Vushtrrisë në sezonin vjeshtor, kurse Lena ishte kapiten i Shkëndijës së Tiranës. Të hënën përgatitjet i ka filluar edhe skuadra e Dritës, e cila synim ka titullin e kampiones në Superligë.

SHKURT

Rexhbeçaj: Zgjedha Kolnin për të luajtur më shumë

Mesfushori nga Kosova, Elvis Rexhbeçaj, edhe zyrtarisht është futbollist i ri i Kolnit. Ai është huazuar në Koln për një vit e gjysmë nga Wolfsburgu. Ai ka deklaruar për faqen zyrtare të klubit se dëshiron të luajë më shumë dhe kjo është arsyeja që zgjedhi Kolnin. "Unë vërtet dua të luaj dhe kjo është arsyeja që unë kam ndërmarr këtë hap për të ardhur këtu. Bisedimet që patëm me Kolnin dhe shansi për t'u zhvilluar gjatë një viti e gjysmë këtu ishin më të përshtatshmet për mua", ka thënë Rexhbeçaj.

Pensionohet Rifat Vula

Stafi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport i organizoi ceremoninë e ditëlindjes dhe njëkohësisht të pensionimit menaxherit 40 vjeçar të Sallës së Sporteve "Shani Nushi", Rifat Vula. Drejtoresha e këtij dikasteri, Saranda Hyseni-Maloku, u shpreh se kontributi i punëtorit shumëvjeçar Rifat Vulës do të mbahet mend përgjithmonë nga stafi i drejtorisë dhe komuniteti sportiv në Gjakovë e më gjerë. Ndërsa Vula ka thënë se nga kjo sallë po largohet me shumë kujtime të bukura, fitore dhe sfida gjatë punës dhe jetës.

Shkëndija largon pesë futbollistë

Shkëndija e Ernest Gjokës ka konfirmuar 5 largimet nga skuadra në fillim të muajit janar. Në gjysmësezonin e mbetur pjesë e kampionëve në fuqi nuk do të jenë Egzon Bejtullai, Zeni Husmani, Shefit Shefiti, Jakup Berisha si dhe Selajdin Mustafi. Bejtullait i skadoi kontrata, teksa zgjedhi të mos rinovonte, teksa dëshiron që karrierën ta vazhdojë jashtë vendit. Me marrëveshje të dyanshme është ndërprerë edhe bashkëpunimi me mesfushorin Zeni Husmani si dhe me të rinjtë si Shefiti, Berisha e portieri Mustafi që nuk gjetën shumë hapësirë për të luajtur. Shkëndija ka falënderuar të pesë futbollistët për angazhimin e tyre në fanellën kuqezi, ndërkohë që pas futbollistit të kombëtares shqiptare, Valon Ahmedit, priten të tjera afrime të bujshme në radhët e tetovarëve.

Greca largohet nga Gjilani, afër rikthimit në Shqipëri

Bedri Greca është larguar nga skuadra e Gjilanit që drejtohet nga Gentian Mezani. Aktualisht shihet rikthimi në Superiorene e Shqipërisë si pista më e mundshme për Bedri Grecën. I dashuruar pas klubit dhe qytetit të Tiranës, por ende nuk dihen qëndrimet e këtij klubi për të menduar edhe një rikthim të këtij lojtari. Megjithatë, shumë gjatë nuk pret Bylisi, që ka kërkuar menjëherë shërbimet e Grecës. Ende asgjë konkrete, ndërsa një mundësi i është afruar në tavolinë për ta pranuar në merkaton e janarit.

Grelda rikthehet tek Osijeku

GLASGOU, 6 JANAR - Aventura e futbollistit të Kombëtares së Shqipërisë, Eros Grezdes, me skocezët e Rangersit, duket se ka marrë fund, teksa tashmë lojtari do të rikthehet përsëri te kroatët e Osijekut. Sipas asaj

që shkruan "The Sun", pas një viti e gjysmë në radhët e Rangersit, tashmë Grezda do të largohet nga skocezët, teksa është arritur marrëveshja për rikthimin tek Osijeku. Ishin pikërisht këta të fundit që e

transferuan lojtarin në ekipin që drejtohet nga Stiven Gerrardi për shumën e dy milionë eurove, por aventura e shqiptarit me ta nuk shkoi në mënyrën më të mirë të mundshme. Për shkak të disa proble-

meve që kishte pasur me ekipin e të rinjve, ku pështyu kundërshtarin, Gerrard u mërzi shumë me shqiptarin dhe dëshironte largimin e tij. Tashmë karriera e Grezdes do të vazhdojë në Kroaci.



Sot dhe nesër grumbullohen përfaqësueset e reja

PRISHTINË, 6 JANAR - Më 7 dhe 8 janar do të fillojnë grumbullimet e para të përfaqësueseve të reja të Kosovës në basketboll. Të martën dhe të mërkurën në Prishtinë do të stërviten U16 dhe U20, në të dyja konkurrencat. Këto do të jenë grumbullimet e para, derisa gjatë verës ekipet e Kosovës do të garojnë në arenën ndërkombëtare. Grumbullimet do t'u ndihmojnë trajnerëve për ta parë formën e lojtarëve dhe të formojnë një ekip sa më të fortë për garat evropiane. Kosova U20 në konkurrencën e meshkujve do të jetë në Grupin D së bashku me Bullgarinë, Bjellorusinë, Sllovakinë, Finlandën dhe Irlandën. Ndërsa Kosova U18 po ashtu në konkurrencën e meshkujve do të



jetë në Grupin D me Maqedoninë Veriore, Suedinë, Danimarkën, Letoninë dhe Bjellorusinë. U16-shat do të jenë në Grupin B me Shqipërinë, Armeninë, San Mariron, Gjibraltarin dhe Maltën. Ndërsa Kosova U20 në konkur-

rencën e femrave do të jetë në Grupin C me Gjermaninë, Zvicrën dhe Ukrainën. Kosova U16 në konkurrencën e femrave do të jetë në Grupin C me Rumaninë, Sllovakinë, Poloninë, Maqedoninë Veriore dhe Irlandën.

ORARI I GRUMBULLIMEVE

7 dhe 8 janar
Në Pallatin e Rinisë dhe Sportit:
U20 Meshkujt 13:00-15:00
U16 Femrat 15:00-16:30
U20 Femrat 16:30-18:00
1 Tetori
U16 Meshkujt 14:00-16:00

Fitojnë Lakersat, Clippersat dhe Miami

LOS ANGELES, 6 JANAR - Fitorja e pestë radhazi në kampionat për Lakersat, që e mundën me rezultat 106-99 Detroitin, duke ruajtur kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit. Ndeshje në përgjithësi e dominuar nga kalifornianët, ku u dalluan Davisi me 24 pikë e 11 rebounde si dhe James, me një "triple double" (21 pikë, 14 rebounde e 11 asistime). Me fitore kundërpërgjigjet edhe ekipi tjetër i Los Angelosit, ai i Clippersave, që e mundi me rezultat 135-132 New Yorkun, me George e Harrell që së bashku realizuan 70 pikë. Pa probleme fitore ka shënuar edhe Miami, që e mundi me rezultat 122-111 Portlandin, duke qëndruar në vendin e tretë në Konferencën e Lindjes. 7 lojtarë të Miamit realizuan mbi 10 pikë, me



Dragiqin që realizoi 29 pikë e 13 asistime. Skuadra e Memphisit, falë 30 pikëve të Valanciunas, që e mundi me rezultat 121-114 Phoenixin (Booker 40 pikë, por që

mbetën për statistikë). Fiton edhe Minnesota, ndaj Clevelandit (118-103), ndeshje ku diferencën e bënë Dieng me 22 pikë e Napier me 21 pikë.

REZULTATET

Clippers - New York 135-132
Miami - Portland 122-111
Cleveland - Minnesota 103-118
Phoenix - Memphis 114-121
Lakers - Detroit 106-99

SHKURT

Berisha rikthehet te Salzburgu

Sulmuesi nga Kosova, Mërgim Berisha, është rikthyer te Salzburgu. Ai ka qenë i huazuar tek Altachu për një vit. Në sezonin e fundit, tek Altachu në Bundesligën austriake Berisha ka shënuar 7 gola në 17 paraqitje. Në sezonin e mëhershëm kishte shënuar po 7 gola, por në 14 ndeshje.

Ronaldo kërkon kalimin në Bayern

Para përfundimit të karrierës, Cristiano Ronaldo synon t'i fitojë edhe disa tituj në Gjermani, përkatësisht Bundesliga. Ylli portugez ka shprehur pakënaqësinë e projektit aktual të Juventusit, ku ndër ta është edhe triumfi në Ligën e Kampionëve. Kështu raporton "Don Balon". Ronaldo gjatë karrierës ka luajtur për Real Madridin, Manchester Unitedin dhe Sporting Lisbona.

Chelsea ofron 60 milionë paundë për Alaban

Chelsea është futur fuqishëm në garë për shërbimet e mbrojtësit të Bayern Munchenit, David Alaba. Pavarësisht prej deklaratave të fundit të trajnerit të Bayernit, Hansi Flick, i cili pak ditë më parë theksoi se futbollisti është i rëndësishëm për skuadrën dhe se ai nuk është në shitje, numri një i stolit të londinezëve vazhdon të këmbëngulë për 27-vjeçarin, i cili konsiderohet si përforcimi ideal për krahun e majtë, pasi Marcos Alonso dhe Emerson nuk preferohen shumë nga trajneri Frank Lampard. Alaba ka kontratë me skuadrën gjermane edhe 18 muaj, por për të arritur deri te shërbimet e Albas, Chelsea ka gati 60 milionë paundë.

Weneri kërkohet edhe nga Reali

Pas Chelseat edhe skuadra e Real Madridit është futur në garë për shërbimet e sulmuesit gjerman Timo Werner. Gazeta spanjolle "Marca" ka raportuar të hënën se Reali po synon transferimin e Wernerit në fund të këtij edicioni, duke ofruar dëmshpërblim deri në 80 milionë euro për kartonin e tij. Werner është një prej lojtarëve më të dalluar në Bundesligë, pasi këtë edicion ka shënuar 23 gola dhe ka bërë dhjetë asistime në 23 ndeshje për RB Leipzigun në të gjitha garat. 23-vjeçari ka kontratë me RB Leipzigun deri në verën e vitit 2023. Ai te kjo skuadër është transferuar nga Stuttgarti në vitin 2016 për 14 milionë euro, kurse ka edhe 11 gola në 29 ndeshje për Gjermaninë.

Ferrari në bisedime me Vettelin

Sipas së përditshmes gjermane "Bild", skuadra e Ferrarit është gati t'i rinovojë kontratën pilotit gjerman Sebastian Vettel. Kontrata e Vettelit skadon në fund të këtij viti dhe e ardhmja e tij është ende e paqartë. Kohët e fundit është përfolur për një transferim të Lewis HamiltonIT nga Mercedes te Ferrari, por duket se Vetteli i ka bindur drejtuesit e "kokëkuqes" t'ia rinovojnë kontratën dhe të qëndrojë edhe në vitin 2021. Një muaj më parë Ferrari i rinovoi kontratën deri në vitin 2024 pilotit tjetër Charles Leclerc dhe të njëjtën gjë mund ta bëjë edhe me Vettelin. Mes pilotëve kandidatë është edhe Mick Schumacher, por vështirë se djali i Michael Schumacherit të pilotojë një Ferrari që në sezonin e parë në Formula 1. Ndër emrat e tjerë që priten se mund të pilotojnë një Ferrari në vitin 2021 janë: Fernando Alonso dhe Antonio Giovinazzi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të Ligjit të Punës, nr.03/L-212, nën 8 paragrafi 1 dhe 2, nën 10 nënparagrafi 2.1 dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ nr 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale për Arsimit dhe Shkencë shpall:

Nr. 34/20
Datë: 06.01.2020

KONKURS

1. SHFMU "Mushnikovë" në Mushnikovë, një (1) punëtor teknik
2. SHMLM "Luciano Motroni" në Prizren, një (1) punëtor teknik
3. SHFMU "Lekë Dukagjini" në Prizren, një (1) punëtor teknik
4. SHFMU "Abdyl Frashëri" në Prizren, një (1) punëtor teknik
5. SHFMU "Bajram Curri" në Romajë, një (1) punëtor teknik
6. SHFMU "Motrat Qiriazit", një (1) punëtor teknik
7. SHML "Ymer Prizreni" një (1) punëtor teknik

Kontrata e punës : me kohë të pacaktuar

Orari i plotë: 40 orë në javë

Kushtet:

Detyrat dhe përgjegjësit e punëtorit teknik :

- ❖ Kujdeset për nivelin e pastërtisë së hapësirës shkollore
- ❖ Bënë pastrimin e dyshemeve, dyerve, dritarëve, mureve, nyejeve sanitare, korridoreve etj.
- ❖ Pastrimin i rregullt i oborrit të shkollës dhe mirëmbajtja e gjelbërimit në hapësirën shkollore,
- ❖ Njofton për të gjitha dëmet dhe defektet eventuale në shkollë,
- ❖ Kujdeset për ruajtjen e objektit dhe inventarit të shkollës,
- ❖ Kryen punës,
- ❖ Kryen punë të tjera sipas kërkesës së drejtorisë së shkollës.

Kualifikimi : Përgatitja e mesme shkollore:

Çdo kandidat (aplikues) duhet të kompletojë dhe të dorëzojë dokumentacionin e domosdoshëm (fotokopje të vërtetuar) si vijon:

1. Dëshmi mbi përgatitjen profesionale-kualifikimin, fotokopje e vërtetuar,
2. Dokumentin e identifikimit – kopje e letërnjoftimit,
3. Certifikata që nuk është në hetime dhe se nuk është i dënuar për vepra penale,
4. Certifikata mbi gjendjen shëndetësore.

Aplikacionet dorëzohen në Drejtorinë Komunale për Arsimit në Prizren

Afati i aplikimit është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes në web faqe të Komunës dhe mjetet e informimit publik.


Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranojnë.

Sqarim : Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet do të ftohen për test me shkrim dhe në intervistë.

Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% e me shumë të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës

Drejtoresha/ Xhemile Thaçi Vezgishi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

OPŠTINSKI DIREKTORIJAT OBRAZOVANJA U PRIZRENU

Br. 34/20
Dana: 06.01.2020

Na osnovu Zakona o Radu u R. Kosovu br. 03/L-212 član 8, tačka 1 i 2, član 10 tačka 2.1 i na osnovu Administrativno Uputstvo br. 07/2017 (Ministarstvo Rada) – regulisanje procedure konkursa u javnom sektoru, Opštinski Direktorijat Obrazovanja objavljuje ovaj:

KONKURS za slobodna radna mesta

ONŠŠ "Grnčare" u Grnčaru

- Jedan pomoćni radnik (tehničko osoblje)

Ugovor: Na neodređeno vreme
Puna norma: 40 časova nedeljno

Zadaci i obaveze tehničkog radnika:

- ❖ Vodi računa o nivou čistoće u prostorijama škole,
- ❖ Održava i čisti podove, vrata, prozore, zidove, sanitarne čvorove, hodnike i dr.,
- ❖ Redovno čisti dvorište škole i održava zelene površine škole,
- ❖ Obaveštava za sva nastala oštećenja i eventualne defekte u školi,
- ❖ Stara se o objektu i inventaru škole,
- ❖ Izvršava druge poslove prema potrebi i na osnovu zahteva direktora škole.

Uslovi:

- Srednja stručna sprema (diploma srednje škole)

Tražena dokumenta :


- Kopija diplome – overena fotokopija
- Kopija lične karte.
- Potvrda izdata od Kosovske Policije da kandidat nije ikada bio osuđivan za krivično delo.
- Aplikacija koja se dobija u ODO i popunjena se predaje zajedno sa ostalom traženo dokumentacijom u istom Direktorijatu.
- Uverenje o zdravstvenom stanju – izdato od strane državne zdravstvene ustanove,

❖ Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja na zvaničnoj Web stranici Opštine Prizren.

❖ Sve aplikacije koje budu dostavljene posle predviđenog roka, neće biti razmatrane.

❖ Svi kandidati biće podvrgnuti pismenom testiranju i oni kandidati koji dobiju 50% predviđenih poena sa testa, biće pozvani na intervju.

Opštinski Direktorijat Obrazovanja
Direktor / Xhemile Thaçi Vezgishi



Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lumë's Details
lumesdetails
Mbropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

U bënë 20 vite pa vëllain tonë të dashur



Mehmet B. Miftari

(1942-2000)

E kujtojnë me mall të pa shuar motrat: Fatimja, Hyra, Zahidja si dhe vajza Sania nga Skenderaj dhe Diaspora.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212), Vendimit të Bordit Nr.06 të datës 25.07.2019 për shpalljen e konkursit, dhe gjendjes momentale, nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhëshme një vjeqare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A vendosi që më datë 06.01.2020 të shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës:

- Zyrtar për Mardhënie me Klient** - me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeqare), me mundësi vazhdimi

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Organizon dhe mbikqyrë procesin e punës në Shërbimin me klient në funksion të inkasimit efektiv të faturave për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.
- Harton planin dhe programin e punës mbi aktivitetet në arritjen maksimale të shkallës së inkasimit dhe regjistrimit të çdo konsumatori.
- Mbikqyrë punën e koordinon punën e inkasimit dhe raportet e punës së tyre.
- Përgjigjet në ankesat e konsumatorëve dhe ndërmerr veprimet e nevojshme për realizimin e kërkesave sipas vërejtjeve lidhur me kualitetin e shërbimeve.
- Pjesmarrja në përpilimin, projektimin dhe kordinimin e planeve dhe përgjegjësia për zbatimin e tyre.
- Përgadit kontratat me konsumatorët dhe mban evidencën e tyre me të gjitha elementet e nevojshme.
- Kujdeset për zbatimin e Kartës së konsumatorëve dhe bashkëpunon me udhëheqsin operativ në funksion të inkasimit sa më të lartë, i raporton Zyrtarit të lartë financiar për të gjitha qështjet relevante financiare nga Shërbimi me klient në bazë të raportit mujor, mbi ndryshimet financiare dhe hamonizimin e kontratave për shërbimet me tarifrat në fuqi.
- Për çdo kontratë për shërbime, një kopje ia dorëzon udhëheqësit të operativës duke njoftuar atë për çdo ndryshim eventual të pastajshëm mbi kushtet nga kontrata bazë.
- Për vërejtjet e konsumatorëve në lidhje me shërbimet, me kohë e njofton me shkrim udhëheqësin e operativës. Paraqet raporte mujore mbi kërkesat dhe punën me konsumatorë-kljentë.
- Kryen edhe punë tjera sipas urdhërit të eporit të drejtëpërdrejtë.

Kualifikimet

- Të ketë diplomën Universitare
- Ta prezantoj kopjen e leternjoftimit
- Çertifikatë nga gjykata se nuk jeni i/e denuar (më e re se 6 muaj)
- Cv-në

Aplikacionin së bashku me diplomën, referencat etj. mund të dorëzohen në Zyrën e Arkivës, në Kompaninë Regjionale të Mbeturinaeve "Uniteti" Sh.A. Mitrovicë. Konkursi do të jetë i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore prej 06.01.2020 deri më datën 21.01.2020. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit Vlerësues. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhet pas përfundimit të afatit të aplikimit.

Oferte për shitjen e patundshmërisë

1. Veli (Binak) Gashi, me adrese ne fsh. Atmagje, K.K Prizrenit, është bashkëpronar me pjesën 1\2 e pjesës ideale (rreth 2502.5 m2), te patundshmërisë, me numër te Njesisë kadastrale P - 71813001-00331-0, ne vendin e quajtur "Rupa - Kodra", me kulture bujqësore - are e kl .4, në sipërfaqe te përgjithshme prej 5005 m2, Zona kadastrale Atmagje .

Nga pjesa e vet ideale oferton për shitje tere siperfaqen prej 1\2 e pj.ideale te ngastrës kadastrale (2502.5 m2) te patundshmërisë me te dhënat si me larte, ne shumen e përgjithshme prej (3×8.000 E =24.000 E (me shkronja : Njezet e katërmijë euro).

Prizren, 06.01.2020
Ofertuesi Veli Gashi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besart (Rasim) Mustafaj, shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e SH.M "Qendra e Kompetencës" Skenderaj.
- Shpejtim Beka, shpall të pavlefshme dëftesën e SHF "Ismet Uka" Ticë.
- Kadrije Lahu shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit " Biznesi " me numër 37/16 të programit : Master i arteve në menaxhment dhe financa.
- Valentina Ramadan Sejdiu shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit Ekonomik të UP-se, Bachelor Prishtinë.
- Kadrije Lahu shpall të pavlefshme dëftesën e kolegjit të Biznesit me nr: 37116 të programit master të arteve në menaxhment dhe financa.
- Kadrije Lahu shpall të pavlefshme diplomën e kolegjit të biznesit baxhelor i arteve në menaxhment dhe ekonomi.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkudjesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralla Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook




www.facebook.com/gjeipuneshpeite

KALONI FESTA TË GËZUARA DHE EFIÇIENTE!


BËHUNI BASHKË

Mblidhuni tek kushdo që ka shtëpinë më të madhe dhe më të izoluar – qoftë në shtëpinë tuaj, apo tek familjarët/miqtë tuaj. Ngrohja e një hapësire të përbashkët, në vend të më shumë hapësirave, do të kursejë energji, por edhe do të ngrohë zemrat tuaja.



DASHURINË DHE NGROHTËSINË MBAJENI BRENDA

Izoloni mirë dyert dhe dritaret. Në n dërkohë, deri sa të aplikoni për mbështetje nga programi SEEK, gjeni shirita izolues nëpër dyqane me produkte ndërtimore.



ENËT DHE RROBAT LANI PËRNJËHERË

Mbusheni makinën e larjes së enëve maksimalisht para se t'a ndizni atë. Njësoj veproni edhe me rrobalarësen, por këtë herë vendoseni në minimum temperaturën e ujit.



GATUANI PËR NJËRI-TJETRIN

Përgatitni aq sa keni nevojë, por përgatitni çdo gjë në të njejtën kohë. Një furrë që punon me kapacitet maksimal shpenzon më pak energji se sa disa furra që shfrytëzohen pjesërisht por që punojnë gjatë tërë ditës.



PËRQAFOHUNI

Shpërndani energji pozitive tek njëri-tjetri. Kjo do të ju ngrohë juve dhe atë që e përqafoi, pa pasur nevojë të përdorni burime tjera të ngrohjes.

MILLENNIUM FOUNDATION KOSOVO JU URON FESTAT E FUNDVITIT!

Në vitin 2020, vizitoni faqen tonë millenniumkosovo.org/seek për të përftuar nga SEEK - Subvencionet për Energji Efikase, programi që mbështetë familjet në investime për eficiency të energjisë.